



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional  
“Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit  
Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” i  
Kolegjit Universitar “LOGOS”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



PhD Elena Kokthi

PhD Klodjan Rama

Dhjetor 2021

**Për Programin e studimit Diplomë Profesionale në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	KU LOGOS
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Agrobiznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 405, Datë 25.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr.93, datë 06.03.2017
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Diplomë Profesionale
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2019-2020 – 6 studentë v.a 2020-2021 – 4 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "LOGOS" (më tej KU LOGOS), është një institucion privat i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Kolegji Universitar "LOGOS" është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1055, datë 29.07.2009. KU LOGOS është riorganizuar me Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit UMAS Nr. 93, date 06.03.2017 "Për miratimin e statutit të Kolegjit Universitar Logos".

KU "LOGOS" është organizuar në 3 Fakultete:

### 1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

### 2. Fakulteti Ekonomik

### 3. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.

Programi i studimit Diplomë profesionale në "Agrobiznes" ofrohet nga Fakulteti Ekonomik i cili ofron në departamentet përkatëse programet e studimit si vijon.

#### Fakulteti Ekonomik-Departamenti Financë Kontabilitet

- i. në ciklin e parë: Bsc në "Financë Kontabilitet"
- ii. në ciklin e dytë: MP në "Financë kontabilitet";

#### Fakulteti Ekonomik-Departamenti i Menaxhimit

- i. në ciklin e parë: Bsc në "Menaxhim Biznesi"  
Bsc në "Menaxhim Turizmi"


#### Fakulteti Ekonomik-Departamenti i Agrobiznesit

- i. në ciklin e parë: Dp në "Agrobiznes"

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit "Diplomë profesionale në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore". Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti Ekonomik) Programi i studimit është licencuar me UMASR Nr. 405 datë 25.07.2019.

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti përkatës pranë KU LOGOS është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i KU LOGOS dhe Rregullorja e programit të studimit.

Stafi i angazhuar në këtë program studimi (PS) është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Megjithatë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme sidomos sa i përket moduleve që lidhen direkt me emërtimin e PS. Më konkretisht GVJ rekomandon: rishikimin e moduleve të përfshira në programin e studimit, në to vihet re ofrimi i programeve të ngjashme në nivelin bachelor (Bsc) nga IAL të tjera në vend si Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti i Korçës. Përshtatjen e përmbajtjes së objektivave të nxënies me profilin e studentit të targetuar nga DP. Përshtatja e syllabuseve sipas VKM Nr 185 sa i përket pjesës së punës praktike dhe teorike 50/50.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**


Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Diplomë profesionale në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore" ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti Ekonomik) pranë KU LOGOS filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në KU LOGOS u realizua gjatë datave 16-17/06/2021, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ u takua me: Përgjegjësën e Departamentit dhe Dekanin e FE, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm, me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm), me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore etj.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL, MSc. Arjana Alija.



Më datë 16.12.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 9/31 Prot, datë 17.12.2021 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 17.12.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr. 127 Prot, datë 23.12.2021.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

## **I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT DIPLOMË PROFESIONALE**

### **Standarti I.3.Kriteri 5**

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

*Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.*

### **Komenti i institucionit**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 10).** Gjithashtu, vërehet një mbingarkesë mësimore nga ana e stafit akademik, ku disa lektorë japin deri në 6 lëndë (p.sh Olda Cico, Ledia Sula, Iva Sulaj). Në disa raste, ka staf akademik që figurojnë si titullar lëndë në syllabuse e paraqitura, por që nuk janë paraqitur fare si staf akademik në tabelën e stafit akademik (Shih Tabela për stafin akademik, Agrobiznes.xlsx), si p.sh Genci Pasko, apo Jehona Gërmizi sqarojnë se:

*Gjatë vizitës së zhvilluar në institucion, nga GVB është sqaruar rasti i lektorit Genci Pasko. Ekspertët janë sqaruar për ndryshimet e nevojshme që janë bërë në Departament në semestrin e dytë, për shkak të humbjes së jetës së një nga anëtarët e personelit akademik të departamentit nga COVID 19 në Mars 2021. Genci Pashko i cili për vitin akademik 2019-2020 dhe deri në Mars 2021 ka qenë pjesë e stafit akademik.*

*Ndërsa titullari i lëndës "Bazat e Kontabilitetit" J Germizi është pjesë e stafit akademik të Fakultetit Ekonomik, konkretisht e Departamentit Financë-Kontabilitet dhe ka hartuar dhe firmosur syllabus-in për lëndën Bazat e Kontabilitetit, bazuar në profilin e saj shkencor. Kjo reflektohet edhe në pasqyrat përkatëse të stafit akademik për semestrin e parë dhe të dytë të viteve akademike 2019-2020, 2020-2021. Është shpjeguar paraqitja e tabelave përkatëse në funksion të këtij ndryshimi, për arsye të të cilit tabelat janë vendosur në cdo semestër. (Tabela 5.1, 6.2, 6.3, 6.4-Tabelat përmbledhëse 1-24 ANEKS SIPAS RVB).*

*Gjithashtu lektorët në Kolegjin Universitar Logos kanë ngarkesa sipas normave të lejuara dhe të parashikuara në VKM-të përkatëse. Referuar tabelave të ngarkesave, për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021, Olda Cico si dhe Ledia Sula, në detyrën e Përgjegjësës së Departamentit, nuk kanë dhënë 6 lëndë. Asistente-lektore Msc Iva Sulaj, ka dhënë 6 lëndë*



*dhe është përgjigjur për praktikat e studentëve. (Tabela 4.1, 4.2-TABELA PËRMBLEDHËSE 1-24 ANEKS SIPAS RVB).*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ falënderon për sqarimet shitesë në lidhje me stafin por gjithsesi është e mendimit që këto sqarime nuk ndikojnë në vlerësimin e standartit përkatës sepse si është thënë më sipër modulet e përfshira në këtë program studimi kanë një orientim të menaxhimit të sipërmarrjeve në nivel teorik dhe praktik të pabalancuar. Po kështu sa i përket angazhimit të pedagogëve dhe lëndëve që ata japin nuk i jemi referuar vetëm programit të studimit profesional 2 vjeçar në Agrobiznes por edhe angazhimin e pedagogëve në programe të tjera studimi. Kështu pedagogu Olda Cico jep 6 lëndë (parimet baze të marketingut, sjellje konsumatore, menaxhim agrobiznesi, menaxhim marketingu, drejtim marketingu, sipërmarrje, makroekonomi. Megjithatë më problematike paraqitet situata për pedagogun Iva Sulaj e cila jo vetëm ofron një numër të lartë lëndësh por edhe profili i lëndëve është i ndryshëm. Për shembull pedagogu në fjalë jep lëndët e Kontabilitetit dhe Menaxhimit të teknikës Bujqësore. Gjykojmë që kjo e fundit duhet të ofrohet nga pedagogë që kanë formim në shkenca bujqësore.

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**


### **Standarti I.3. Kriteri 6**

#### **Komenti i institucionit**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 11-12),** Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL është e rekomandueshme që objektivat për formimin profesional të mos formulohen në mënyrë përgjithësuese (generaliste), por të përshtaten dhe nivelit të studentëve dhe lëndëve të tjera që ofrohen nga programi Agrobiznes. P.sh. një nga objektivat e Lëndës Marketing Agrar është që studenti të marrë dije se si grumbullohen të dhënat primare dhe sekondare në semestrin e I-rë, ndërkohë që lënda specifike për mbledhje të dhënash ofrohet në Semestrin e II-të. Për më tepër, në Lëndën e mbledhjes së të dhënave nuk shpjegohet se cilin program (software) statistikor studentët do të përdorin në analizimin e të dhënave; do të jetë excel, apo ndonjë program tjetër statistikor siç mund të jetë STATA, R, SPSS, etc. Lënda Informatikë e zbatuar që ofrohet në semestrin e I-rë ka vetëm konceptet bazë të programeve të Microsoft ëindoës (MS Word, Excel, Poëerpoint). Prandaj është e rekomandueshme që objektivat të formulohen në përputhje me nivelin e programet e studimit dhe kërkesat e tregut të punës të nxjerra nga analizat e ndërmarra nga insitucioni.

*Lënda Informatikë e Zbatuar që zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë u jep studentëve të programit profesional koncepte bazë të programeve të Microsoft Office dhe ka pikë të fortë realizimin e orëve në laborator, të shprehur IECT nga 6 pikë që ka lënda.*

*Përsa i përket lëndës Mbledhje e Përpunim të Dhënash, softëare i parashikuar për zbatimin e lëndës është Excel dhe R (si program Open Source Free). Duke qenë se programi është*



profesional, është gjykuar se përdorimi i Excel-it, përmbush më së miri nevojat e studentëve të këtij programi. Në lëndët e tjera specifike të programit, objektivat duhet të përshtaten më mirë me nivelin e studentëve dhe karakteristikat e programit profesional.

### **Argumentimi i GVJ**

Gjykojmë që sqarimet për çdo kriter nuk mund të bëhen të shkëputura nga logjika e rekomandimeve të bëra nga GVJ për programin e studimit në tërësi. Thelbi i vlerësimit të këtij kriteri, por jo vetëm, nuk ka të bëjë ekskluzivisht se cilin program kompjuterik studentët mësojnë apo përdorin, por ka të bëjë më shumë me përmbajtjen e modulit specifik (p.sh mbledhja e të dhënave) dhe lidhjen me modulet e tjera të programit të studimit. Nëse në modulim mbledhja e të dhënave studenti mëson rreth shpërndarjeve statistikore apo testimit të hipotezave, GVJ nuk vëren në asnjë moment se si dhe me cilat instrumente studentët do mësojnë të i aplikojnë apo praktikojnë këto koncepte teorike.

Siç është përmendur dhe më herët, edhe në këtë kriter GVJ analizon në vazhdimësi faktin që programi i studimit ka nevojë të përshtatet jo vetëm sa i përket lëndëve të përfshira në të por edhe lidhjen e tyre me lëndë të tjera. Sqarimet në lidhje me lëndët e informatikës i vlerësojmë por gjithsesi kjo nuk ndikon në vlerësimin e standartit.

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**

## **II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**


### **Standarti II kriteri 2**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 11-12):** Sidoqoftë vërehet një mospëputhje e madhe në ngarkesën në kredite të moduleve të Semestrit të I-rë, viti i I-rë. Për shembull, moduli Baza të Ekonomisë ngarkesën totale të ECTS e ka 12, ku vetëm leksionet kanë 6 ECTS, Seminaret 3 ECTS, Ushtrimet/Detyrë Kursi 1.5 ECTS, dhe Laborator/praktikë 1.5 ECTS. E njëjta gjë vlen për modulet Menaxhim Agrobiznesi dhe Baza të Kontabilitetit. Ndërkohë, modulet Gjuhë e Huaj (Anglisht) kanë 6 ECTS për Leksionet dhe 6 ECTS për Ushtrime/Detyrë Kursi. Moduli Informatikë e Zbatuar ka 6 ECTS për Leksionet, 3 ECTS për Seminaret, 0.5 ECTS për Ushtrime/Detyrë Kursi, dhe 1.5 ECTS për Laborator/Praktikë, sqarojmë se:

*Modulet Baza të Ekonomisë, Menaxhim Agrobiznesi, Baza të Kontabilitetit, kanë ngarkesë 6ETC nga të cilat leksionet kanë 3ECTS, seminarat 1.5ECTS, Ushtrimet/Detyra Kursi 1.5 ECTS. Moduli informatikë e zbatuara ka 6ECTS, nga të cilat leksionet kanë 3ECTS, seminarat 0.5ECTS, Ushtrimet/Detyra Kursi 1.5 ECTS, Laborator/Praktikë 1ECTS. (Tabela 10.1, 10.2, 10.3, 10.4 Tabelat Përmbledhëse 1-24 Aneks sipas RVB).*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ i është referuar dokumentit „19.3 Plani mësimor 2020-2021.pdf”. Është e rëndësishme që të ruhet konsistenca në dokumentacionin e paraqitur për vlerësim.



**Per sa me sipër komenti i institucionit per kete standard nuk pranohet.**

### **Standarti II kriteri 3**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 13 )**Ndërkohë, për sa i përket Programit Profesional Marketing i Produktit Bujqësor, edhe pse orët totale janë referuar me ngarkesë 150 orë, nga ku 60 orë në auditor dhe 90 studim individual, Leksionet për Modulet: Bazat e Ekonomisë, Menaxhim Agrobiznesi, Baza të Kontabilitetit, dhe Gjuha e Huaj (Anglisht) janë të shënuara me 0 orë, edhe pse ngarkesa në kredite ECTS është 6 për secilën prej moduleve. Gjithashtu, Moduli Informatikë e Zbatuar ka ngarkesë në orë në auditor për sa i përket leksioneve me 1 orë, ndërkohë ngarkesa me kredite është gjithashtu 6. Kjo është një mospërputhje esenciale dhe bie ndesh me ligjin nr. 80/2015 sqarojmë se:

*Programi i studimit me karakter profesional në Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhimi i Fermës Bujqësore" ka të njëjtën strukturë për të dy profilet. Modulet Baza të Ekonomisë, Menaxhim Agrobiznesi, Baza të Kontabilitetit dhe Gjuha e Huaj (Anglisht) janë të trungut të përbashkët dhe si të tilla kanë një shpërndarje ECTS për të dyja profilet (Tabela 10.1, 10.2, 10.3, 10.4 Tabela përmbledhëse 1-24 ANEKS SIPAS RVB).*

### **Argumentimi i GVJ**

**Per sa me sipër komenti i institucionit per kete standard nuk pranohet.** GVJ i është referuar dokumentit "19.3. Plani mësimor 2020-2021.pdf". Është e rëndësishme që të ruhet konsistenca në dokumentacionin e paraqitur për vlerësim.

### **Standarti II.2 kriteri 4**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 17 )** Më specifikisht, Programi Profesional Menaxhim i Fermës Bujqësore, bazuar në planin mësimor 2020-2021 si dhe planin mësimor 2019-2020, përmban 170 orë praktikë nga 1200 orë total në auditor, **ku në përqindje është 14%. Kjo ndarje është nën minimumin ligjor prej 25% të përcaktuar në VKM Nr. 185. Dt 25.3.2021** sqarojmë se:

*Programi profesional në të dyja profilet përmban në total 180 orë në praktikë (mësimore dhe profesionale) (Tabela 10.1, 10.2, 10.3, 10.4 TABELAT PËRMBLEDHËSE 1-24 ANEKS SIPAS RVB). Programi është licencuar me vendim nr.405, datë 25.07.2019 dhe kjo bën të pamundur të zbatohet dispozitat e VKM nr 185, datë 25.03.2021.*

*Në respekt të përmirësimit të vazhdueshëm të programit dhe kushteve ligjore në fuqi, është përgatitur drafti planit mësimor të rishikuar dhe është kërkuar nga pedagogët rishikimi i syllabuseve para dërgimit të Draft Raportit të Vlerësimit të jashtëm. Sugjerimi juaj i drejtë është miratuar tashmë nga strukturat e brendshme të Kolegjit. (Bashkëngjitur procedura e rishikimit)*

### **Argumentimi i GVJ**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



GVJ gjykon që ndryshimi kohor midis liçencimit dhe VKM nr 185, datë 25.03.2021 nuk përbën një argument të qëndrueshëm sepse KU LOGOS mund të kishte ndërmarrë një proces riorganizimi të programit të studimit pranë MASR dhe në vijimësi të kishte filluar procesin e akreditimit të programit të studimit. Po kështu njësia bazë ka të drejtë të ndryshojë deri në 20% të programit të studimit pa qenë në kundërshtim me ligjin.

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**

### **Standarti III.2. Kriteri 3**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 23 )** Referuar syllabuseve të paraqitur në planin mësimor 2020-2021, literatura bazë dhe mbështetëse është në shumë raste e bazuar në leksione të përmbledhura, e vjetëruar si dhe e papërshtatëshme për nivelin e programit të studimit sqarojmë se:

*Literatura e përdorur i referohet ofertës së axhornuar të botimeve universitare në treg. Në mënyrë sistematike leksionet janë axhornuar sipas viteve akademike.*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ gjykon që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të përditësuar literaturën. Në modulën Fitotekni, literatura e rekomanduar është grup autorësh Botim i viti 1987; në modulën Çmimet e produkteve bujqësore, literatura bazë dhe e rekomanduar nuk ka një vit botimi; në modulën Baza të Ekonomisë, literatura e rekomanduar Mankiw 2003, 2005, apo Varian 2000 janë të një niveli shumë të avancuar).

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**

### **Standarti III.4. Kriteri 3**

**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 26 )**, Duke marrë në shqyrtim syllabuset e lëndëve vihet re që edhe pse ka një diversitet në format e kontrollit të njohurive, GVJ gjykon që format e ndryshme nuk janë konform rregullit 50/50 që parashikohet në VKM nr 185 datë 25.03.2021 ndryshim i VKM 41 sqarojmë se:

*Programi është licencuar me vendim nr.405, datë 25.07.2019 dhe kjo bën të pamundur të zbatohet dispozitat e VKM nr 185, datë 25.03.2021.*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ gjykon që ndryshimi kohor midis liçencimit dhe VKM nr 185, datë 25.03.2021 nuk përbën një argument të qëndrueshëm sepse KU LOGOS mund të kishte ndërmarrë një proces riorganizimi të programit të studimit pranë MASR dhe në vijimësi të kishte filluar procesin e akreditimit të programit të studimit. Po kështu njësia bazë ka të drejtë të ndryshojë deri në 20% të programit të studimit pa qenë në kundërshtim me ligjin.

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**

### **Standarti VI.1. Kriteri 3**


**Duke u nisur nga konstatimi në draft raport (fq. 33 ),** Nga të dhënat e departamentit të Agrobiznesit rezulton që për stafin e angazhuar në të dy vitet akademike për këtë program studimi, 55% e stafit është PAE ndërsa rreth 45% janë PAK duke qenë në kundërshtim me rregullin 70% PAE dhe 30% PAK.

*Referuar tabelës 7 (Tabelat përmbledhëse 1-24 ANEKS SIPAS RVB), për vitin akademik 2019-2020, raporti PAE/PAK është 13/4 ose 76.5%/23.5%, ndërsa për vitin akademik 2020-2021 raporti PAE/PAK është 10/4 në konformitet të plotë me kuadrin ligjor. Gjithashtu referuar tabelave 4.1, 4.2 për vitin akademik 2019-2020, në orë mësimore, ky raport është 360/240 orë ose 60%/40% dhe për vitin akademik 2020-2021 ky raport është 984/240 ore ose 80.4%/19.6%.*

### **Argumentimi i GVJ**

Në këtë kriter GVJ ka shkruar gjithashtu që: *Megjithatë, KU LOGOS ka lidhur një marrëveshje me MASR "Për përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë në njësitë bazë në kolegjin universitar "Logos" në datën 10.07.2019. Kjo marrëveshje është marrë parasysh në vlerësimin e kriterit duke mos penalizuar institucionin. Pra vlerësimi i kriterit përkatës është bërë duke marrë parasysh marrëveshjen me MASR dhe nuk ka ndikuar negativisht në vlerësimin e standartit.*

**Per sa me sipër, sqarimi i i institucionit vlerësohet por nuk ndikon në ndryshimin e vlerësimit të standartit përkatës.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhimi i Fermës Bujqësore"**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Referuar dokumentacionit, programet e studimit të ofruara në Kolegjin Universitar "Logos" janë të hartuara sipas Planit Strategjik 2018-2024 (Shtojca 3.), i cili është i orientuar drejt zhvillimit të kurikulave dhe mësim-dhënies, kërkimit shkencor, partneritetit dhe ndërkombëtarizimit të institucionit, duke marrë në konsideratë proceset zhvillimore të shekullit 21.</p> <p>Me rëndësi specifike për programet e studimit profesional dy-vjeçar në Agrobiznes me profile "Menaxhimi i Fermës Bujqësore" dhe "Marketing i Produktit Bujqësor" janë objektivi i forcimit të partneritetit me institucione të ndryshme publike dhe private në sektorë të ndryshëm të cilët do i ofronin studentave mundësi për praktika mësimore dhe orientimi drejt mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve (f. 22-23 e Shtojcës 3).</p> <p><i>3. - Plani-Strategjik-2018-2024-al.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Bazuar në Statutin e Kolegjit Universitar "Logos" drejtimit prioritare janë të përcaktuara drejt "kontributit në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit" (Shtojca 2, neni 3-c).</p> <p>Sidoqoftë, rregullorja e përgjithshme e KU "Logos" duhet të reflektojë edhe përcaktimet rregulluese që janë të lidhura me programet e studimit profesional dy-vjeçar, pasi në Rregulloren e Institucionit janë të reflektuara vetëm përcaktimet për nivelin e parë (bachelor) dhe të dytë (master – shkencor dhe profesional).</p> <p><i>2. - Statuti i KU "LOGOS".pdf</i> <i>5. - Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	<p>Programet e studimit profesional dy-vjeçar në Agrobiznes, specifikisht "Menaxhim i Fermës Bujqësore" dhe "Marketing i Produktit Bujqësor" ofrohen nga Departamenti i Agrobiznesit në bazë të përcaktimeve ligjore të lëshuar nga MARS, me urdhër nr. 405, dt 25.07.2019, dhe janë bashkëngjitur Fakultetit Ekonomik të KU "Logos".</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Për ofrimin e programeve të studimeve profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, “Menaxhim i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i Produktit Bujqësor” është kryer një studim tregu (Shtojca 16), i cili paraqet një panoramë të përgjithshme të nevojave të tregut të punës në përgjithësi në sektorin e bujqësisë në Shqipëri.</p> <p><b>Studimi i tregut paraqitur në Shtojcën 16 si dhe Shtojca 17 nuk kanë datë apo vit kur është kryer. Do ishte mirë, që të tillë dokumenta që janë të bazuar në studime dhe analizë të dhënash, të tregojnë datën dhe vitin e kryerjes, pasi reflekton seriozitetin dhe profesionalizmin akademik dhe kërkimor të hartuesve të tyre.</b></p> <p><i>16. - Studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. - MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimit në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Për ofrimin e programeve të studimeve profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, “Menaxhim i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i Produktit Bujqësor” janë paraqitur dy dokumenta, Shtojcat 16 dhe 17, të cilat prezantojnë dinamikën e tregun e punës në sektorin e bujqësisë në Shqipëri. Njëlloj me komentimin më lart (Kriteri 4), studimet nuk tregojnë qartësisht kur janë kryer.</p> <p><i>16. - Studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. - MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Studimet e tregut të paraqitura në dokumentacionin shoqëruar janë kryesisht të bazuara në të dhëna sekondare nga studime të mëparshme si dhe në të dhëna statistikore nga INSTAT. Të dhënat parësore nuk janë reflektuar qartësisht. Gjithashtu, studimet e tregut janë përgjithësues në nevojat e sektorit të bujqësisë, sidomos kur flitet për institucionet politik-bërëse dhe vendim-marrëse (Shtojca 16, fq 6), pasi angazhimi në këto institucione kërkon nivel akademik dhe profesional më të lartë se studimet profesionale dy-vjeçare.</p> <p><i>16. - studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. - MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X		

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Mbarëvajtja, mbikëqyrja dhe marrëdhëniet e institucionale të personelit dhe stafit akademik të programeve të studimit profesional dy-vjeçar (Menaxhimi i fermës bujqësore dhe Marketing i produktit bujqësor) rregullohen nëpërmjet rregulloreve të brendshme të institucionit, siç është Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Agrobiznesit, Rregullorja e Fakultetit Ekonomik, Rregullorja e institucionit KU “Logos”, Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Politika e Cilësisë, si dhe Analiza Vjetore e Departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, Kolegji Universitar “Logos” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si akademike siç është rasti i Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin Fan Noli të Korçës, ashtu dhe me institucione private për kryerjen e praktikave mësimore.  <i>34. - Marreveshjet e praktikës.pdf</i> <i>35. - RAPORT I PERFITIMEVE NGA MARREVESHJET E PRAKTIKES.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Duke qenë se programet e studimit profesional dy-vjeçar me profil “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor” janë hapur në vitin akademik 2019-2020, dhe për shkak të krizës së krijuar nga pandemia e Covid-19, nuk pritet që programet e studimit të japin efekte të menjshme.  Sidoqoftë, një sërë bashkëpunimesh janë ndërmarrë nga aplikuesi për akreditimin e këtyre dy programeve të studimit, reflektuar në raportin vjetor të institucionit KU Logos (Shtojca 37). Ndër ta mund të përmenden angazhimi me kohë të pjesëshme i dy lektorëve nga Fakulteti i Bujqësisë së Universitetit Fan Noli të Korçës, të cilët ishin gjithashtu prezent (online) gjatë vizitës së kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në institucion.  <i>37- Raporti Vjetor 2019-2020_Kolegji Universitar Logos</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Edhe pse programet e studimit profesional dy-vjeçarë “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor” janë licensuar vetëm prej vitit akademik 2019-202, institucioni KU Logos ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë privatë që operojnë në fushën e bujqësisë siç janë Flori Uka P.F dhe shoqërinë tregtare VJEN, ku studentët e programeve studimore dy-vjeçare të lartpërmendura mund të ndjekin praktikën mësimore (Shtojca 34).  <i>34- Marrëveshja e Praktikës</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa	Referuar dokumentacionit të dorëzuar për akreditimin e

specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p>programeve të studimit profesional dy-vjeçar, objekt i këtij vlerësimi, institucioni KU Logos ka përgatitur infrastrukturën për rrjetëzimin e studentëve Alumni. Efekti i infrastrukturës do të shihet pasi të ketë përfunduar diplomimi i brezit i parë i të diplomuarve.</p> <p>Megjithatë institucioni ka marrë pjesë në panairin e punës Eork and Study në 2019 si dhe këshillimin e karrierës zhvilluar online, gjë që tregon që institucioni është aktiv në krijimin e mundësive për studentët e tij.</p> <p><i>51.1 - Pjesëmarrja në Panairin e Punës.pdf</i>  <i>51.3.4. - KESHILLIMI I KARRIERES ONLINE.pdf</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	



<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe G: umbullimit të Krediteve (ECTS).	Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, programet e studimore diplomë profesionale dy-vjeçare janë organizuar në bazë të legjislacionit të arsimit të lartë në fuqi, Ligji nr. 80/2015 datë 22 07.2015, neni 72. Kurikulat e të dyja programeve janë hartuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në lidhje me karakterizimin e lëndëve në lëndë bazë, karakterizuese, dhe integruese.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe pas vizitës së kryer në KU Logos nga grupi i vlerësimit të jashtëm, siç janë kurikulat e programeve të studimit për diplomë profesionale dy-vjeçare në profilet “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor”, si dhe plani strategjik 2018-2024, synon ofrimin e njohurive teorike dhe praktike sipas profileve përkatëse.  Sidoqoftë, duhet theksuar se një pjesë e mirë e moduleve dhe përmbajtja e tyre është më tepër e orientuar drejt menaxhimit të SME-ve, kështu që ka nevojë për përmirësim dhe profilizim drejt menaxhimit të njësive bujqësore. Gjithashtu, modulet dhe temat me përmbajtje teknike bujqësore duhet të marrin një rol më prominent në formimin e studentit, si në aspektin teorik ashtu dhe në atë praktik, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të mbushin boshllëqet profesionale në tregun e punës.  <i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i> <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe pas vizitës së kryer në KU Logos nga grupi i vlerësimit të jashtëm, siç janë kurikulat e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>programeve të studimit për diplomë profesionale dy-vjeçare në profilet “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor”, është e këshillueshme që programet e studimit të parashikojnë më tepër praktika profesionale në terren pasi përfitimet janë të ndërsjellëta.</p> <p>Është e rëndësishme që studentët të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike në lidhje me aspektet e cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet praktikave të mira bujqësore si dhe certifikimet e ndryshme të cilat janë të nevojshme sidomos për profilin e studimit “Marketing i produktit bujqësor”. Aspektet e cilësisë dhe certifikimet janë të rëndësishme për sa i përket tregjeve ndërkombëtare për eksporte por edhe tregut lokal.</p> <p>Këto aspekte teorike dhe praktike është e këshillueshme të reflektohen në programet mësimore dhe syllabuset për të dyja profilet e studimit.</p> <p>Gjithashtu, blegtoria e cila është një sektor i rëndësishëm i bujqësisë shqiptare, pothuaj nuk del në pah në asnjë moment të programit të studimit.</p> <p><i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 – 2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe pas vizitës së kryer në KU Logos nga grupi i vlerësimit të jashtëm, siç janë kurikulat e programeve të studimit për diplomë profesionale dy-vjeçare në profilet “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor”, programet e studimit kanë parashikuar mbikëqyrje të praktikave mësimore reflektuar në formularet e praktikave mësimore.</p> <p>Sidoqoftë, është e këshillueshme që studentët të përfitojnë aftësi praktike që do të ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave të paparashikuara, që karakterizojnë sektorin bujqësor. Siç dihet bujqësia është një nga sektorët që karakterizohet nga një nivel i lartë paparashikueshmërie, sidomos nga faktorët e jashtëm siç janë kushtet atmosferike, por edhe faktorët e brendshëm në përzgjedhjen e kulturave bujqësore që duhet të mbillen, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhurat e fermës bujqësore.</p> <p><i>MFB Raport vlerësimi nga mbikëqyrësi i praktikës.doc</i>  <i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 – 2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar për akreditimin e programit të studimit diplomë profesionale dy-vjeçare në Agrobiznes, me profile “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit</p>


<p>standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>bujqësor”, përmbush përgjithësisht kërkesat ligjore dhe cilësisë së organizimit, strukturës akademike dhe numrit të stafit akademik.</p> <p><b>Megjithatë, organizimi brenda lëndëve/moduleve nuk aspektin e dhënies së dijeve nuk është 50:50 sipas kërkesave ligjore.</b></p> <p><b>Gjithashtu, vërehet një mbingarkesë mësimore nga ana e stafit akademik, ku disa lektorë japin deri në 6 lëndë (p.sh Olda Cico, Ledia Sula, Iva Sulaj). Në disa raste, ka staf akademik që figurojnë si titullar lëndë në syllabuset e paraqitura, por që nuk janë paraqitur fare si staf akademik në Tabelën e stafit akademik (Shih Tabela per stafin akademik, Agrobiznes.xlsx) , si p.sh Genci Pasko, apo Jehona Gërmizi.</b></p> <p><i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 – 2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i>  <i>Tabela per stafin akademik, Agrobiznes.xlsx</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p><b>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, është e rekomandueshme që objektivat për formimin profesional të mos formulohen në mënyrë përgjithësuese (generaliste), por të përshtaten dhe nivelit të studentëve dhe lëndëve të tjera që ofrohen nga programi Agrobiznes. P.sh. një nga objektivat e Lëndës Marketing Agrar është që studenti të marrë dije se si grumbullohen të dhënat primare dhe sekondare në semestrin e I-rë, ndërkohë që lënda specifike për mbledhje të dhënash ofrohet në Semestrin e II-të. Për më tepër, në Lëndën e mbledhjes së të dhënave nuk shpjegohet se cilin program (softëare) statistikor studentët do të përdorin në analizimin e të dhënave; do të jetë excel, apo ndonjë program tjetër statistikor siç mund të jetë STATA, R, SPSS, etc. Lënda Informatikë e zbatuar që ofrohet në semestrin e I-rë ka vetëm konceptet bazë të programeve të Microsoft ëindoës (MS Ëord, Excel, Poëerpoint). Prandaj është e rekomandueshme që objektivat të formulohen në përputhje me nivelin e programet e studimit dhe kërkesat e tregut të punës të nxjerra nga analizat e ndërmarra nga insitucioni.</b></p> <p><i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 – 2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i>  <i>16. - studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. - MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X		

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X		

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, posaçërisht syllabuset e lëndëve (Shih dok 19.4), programi i studimit Agrobiznes me të dyja profilet jep informacion mbi objektivat formues, rezultat e pritshme të të nxënit etj. Për sa i përket fushave të punësimit ato janë të paraqitura në strategjinë e programit dhe në studimet e tregut. Ndërkohë për të dhëna reale të punësimit është e pamundur për momentin për shkak se programi akoma nuk ka nxjerrë brezin e parë të diplomuarve.</p> <p><i>3. - Plani-Strategjik-2018-2024-al.pdf</i>  <i>16. - Studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. -MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor si dhe syllabuset për modulet specifike, programet e studimit janë të organizuara në module të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra që janë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p>Bazuar në planin mësimor 2020-2021, programet profesionale të studimit janë të ndarë në 2 vite, 4 semestra dhe 120 ECTS. Gjithashtu, nga plani mësimor 2019-2020 dhe 2020-2021 (Dokumentet 19.1 dhe 19.3) vërehet se Programi Profesional Marketing i Produktit Bujqësor është i organizuar në Lëndë Bazë (A) me ngarkesë 24 ECTS ose 20%, Lëndë Karakterizuese (B) me ngarkesë 54 ECTS ose 45%, Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (C) me ngarkesë 18 ECTS ose 15%, dhe Lëndë Plotësuesë (D) me ngarkesë 18 ECTS ose 15%. Provimi final (E) ka ngarkesë 6 ECTS ose 5%. Ky organizim përmbush kërkesat e parashikuara nga VKM Nr. 185.</p> <p><b>Sidoqoftë vërehet një mospëputhje e madhe në ngarkesën në kredite të moduleve të Semestrit të I-rë, viti i I-rë. Për shembull, moduli Baza të Ekonomisë ngarkesën totale të ECTS e ka 12, ku vetëm leksionet kanë 6 ECTS, Seminaret 3 ECTS, Ushtrimet/Detyrë Kursi 1.5 ECTS, dhe Laborator/praktikë 1.5 ECTS. E njëjta gjë vlen për</b></p>



	<p><b>modulet Menaxhim Agrobiznesi dhe Baza të Kontabilitetit. Ndërkohë, modulet Gjuhë e Huaj (Anglisht) kanë 6 ECTS për Leksionet dhe 6 ECTS për Ushtrime/Detyrë Kursi. Moduli Informatikë e Zbatuar ka 6 ECTS për Leksionet, 3 ECTS për Seminarët, 0.5 ECTS për Ushtrime/Detyrë Kursi, dhe 1.5 ECTS për Laborator/Praktikë.</b></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, Programi Profesional Menaxhim i Fermës Bujqësore, është organizuar njëloj si programi pararendës, në 2 vite, 4 semestra, dhe 120 ECTS. Edhe organizimi i programit është ndarë në Lëndë Bazë (A) me ngarkesë 24 ECTS ose 20%, Lëndë Karakterizuese (B) me ngarkesë 54 ECTS ose 45%, Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (C) me ngarkesë 18 ECTS ose 15%, dhe Lëndë Plotësuesë (D) me ngarkesë 18 ECTS ose 15%. Provimi final (E) gjithashtu ka ngarkesë 6 ECTS ose 5%.</p> <p><i>Ligji nr. 80/2015 datë 22.07.2015.</i>  <i>VKM Nr. 185. Dt 25.3.2021</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL vërehet se programi i studimit Agrobiznes në të dyja profilet “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor”, përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin, vlerësimin e dijeve etj. (shih Shtojcën 19.3)</p> <p>Përsa i përket ngarkesës mësimore, Programi Profesional Menaxhim i Fermës Bujqësore ka ngarkesë mësimore në orë fizike në auditor (orë totale) 60 orë, ku nga këto, për sa i përket Lëndëve Bazë (A) 30 orë janë leksion (50%), 15 orë seminar (25%), si dhe 15 orë (25%) detyrë kursi. E njëta ndarje është për të gjitha llojet e lëndëve ku janë ndarë në 30 orë (50%) leksione, dhe pjesa tjetër (50%) ose në seminare, detyra kursi, por dhe rrallë dhe në laborator/praktikë.</p> <p>Ajo që vlen të theksohet është se pjesa e praktikës zë një vend shumë të vogël gjatë ngarkesës mësimore në auditor, me përjashtim të lëndës Praktikë Mësimore, semestri i II i vitit të I-rë, e cila ka 60 orë, si dhe lënda Praktikë Profesionale, semestri i IV viti i II-të e cila ka ngarkesë 120 orë, si dhe lënda Informatikë e zbatuar, semestri i I-rë i vitit të I-rë e cila ka 10 orë. <b>Lëndët e tjera, si Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore apo Plotësuese nuk përmbajnë praktikë mësimore gjatë ngarkesës në auditor.</b></p> <p>Provimi final ka një ngarkesë në auditor prej 24 orësh, dhe 126 orë për studim individual.</p> <p>Ngarkesa totale e studentit, në auditor dhe për studim</p>

	<p>individual për të dyja programet është 1776, e cila është konform kërkesave të ligjit (Ligji nr. 80/2015), i cili parashikon jo më pak se 1500 orë.</p> <p><b>Ndërkohë, për sa i përket Programit Profesional Marketing i Produktit Bujqësor, edhe pse orët totale janë referuar me ngarkesë 150 orë, nga ku 60 orë në auditor dhe 90 studim individual, Leksionet për Modulet: Bazat e Ekonomisë, Menaxhim Agrobiznesi, Baza të Kontabilitetit, dhe Gjuha e Huaj (Anglisht) janë të shënuara me 0 orë, edhe pse ngarkesa në kredite ECTS është 6 për secilën prej moduleve. Gjithashtu, Moduli Informatikë e Zbatuar ka ngarkesë në orë në auditor për sa i përket leksioneve me 1 orë, ndërkohë ngarkesa me kredite është gjithashtu 6.</b></p> <p><b>Kjo është një mospërputhje esenciale dhe bie ndesh me ligjin nr. 80/2015.</b></p> <p>Duke filluar nga semestri i II-të i vitit të I-rë deri në përfundim të programit kemi rakordim të ngarkesës me kredite me orët në auditor.</p> <p>Gjithashtu, ngarkesa totale e studentit, në auditor dhe për studim individual për të dyja programet është 1776, e cila është konform kërkesave të ligjit (Ligji nr. 80/2015), i cili parashikon jo më pak se 1500 orë.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>Ligji nr. 80/2015 datë 22.07.2015</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL si dhe gjatë takimeve kryer në institucion gjatë vizitës së GVJ, vërehet se syllabuset e programit të studimit Agrobiznes në të dyja profilet, përmbajnë syllabuset e detajuara për pjesën më të madhe të lëndëve, ushtrimet, etj. Megjithatë, për sa i përket praktikave profesionale, nuk përcaktohet qartë përmbajtja e praktikës, angazhimi i studentit dhe çfarë do të arrihet me angazhimin e studentit.</p> <p><i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshëm i fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL si dhe gjatë takimeve kryer në institucion gjatë vizitës së GVJ, vërehet se struktura dhe organizimi i programit të studimit Agrobiznes në të dyja profilet, kanë nevojë të aktualizohen dhe të përshtaten si me nivelin e diplomës së ofruar ashtu edhe me tregun e punës.</p> <p><b>Në pjesën më të madhe të moduleve, dijet ofrohen në leksione dhe seminare të cilat parashikojnë frekuentim të paktën deri në 70% të ngarkesës akademike. Kjo nuk i</b></p>




	<p>mundëson studentëve mjaftueshëm fleksibilitet për të qenë në terren, nga ku studentët do të përftonin aftësi të nevojshme për t'u përshtatur me tregun e punës.</p> <p>Edhe pse futja e elementëve të rinj si e-Marketing i cili mund të i mundësojë studentëve fleksibilitet për të u angazhuar dhe në distancë, në përgjithësi strukturës së programit të studimit i mungon fleksibiliteti, sidomos nëse mundësitë e punësimit do të ishin në fermtat blegtorale, ku studentët pothuajse nuk marrin as njohuritë e nevojshme.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i>  <i>16. - studim tregu per programin profesional.pdf</i>  <i>17. - MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe në diskutimet me stafin dhe studentët kryer gjatë vizitës në institucion, pjesa praktike e mësimdhënies rekomandohet të ketë një peshë më të madhe në planin mësimor të programit për të dyja profilet, sidomos për profilin “Menaxhim i fermës bujqësore”, Kjo është e rëndësishme për vetë natyrën e diplomës, e cila është e orientuar dhe ka si qëllim të formojë profesionistë të karakterit zbatues (praktik) të cilët do të i shërbejnë tregut të punës në sektorin e bujqësisë.</p> <p><b>Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse, praktika-laboratori zë një rol minimal në shumë module. Module si Menaxhim Agrobiznesi, Drejtim Ferme, Ekstension Bujqësor, apo Baza të Prodhimit Bimor apo Fitotekni kanë nevojë për më shumë ekspozim praktik për studentin, duke i mundësuar vizita dhe pjesëmarrje aktive si në agrobiznese, ferma bujqësore apo institucione publike siç janë Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), ku studentët mund të shohin nga afër proceset e përditshme në këto entitete.</b></p> <p>Sidoqoftë, duke patur parasysh se programi është hapur vetëm rishtaz dhe situata e pandemisë shkaktuar nga Covid19, e ka vështirësuar në masë të madhe lëvizjen dhe pjesëmarrjen fizike në shumë aktivitete, përfshirë këtu edhe kryerjen e praktikave mësimore. Ndaj, angazhimi praktik i studentëve duhet të konsiderohet si prioritar për vitet në vazhdim, gjë e cila duhet të reflektohet më qartë në planin mësimor të programit në të dyja profilet.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i></p>

	19.4 – 2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf MFB Raport vlerësimi nga mbikqyrësi i praktikës.doc			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Elementët e programit të studimit si emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Programi është i ndarë në 2 vite, katër semestra, në 120 ECTS, ku 1 ETCS është 25 orë totale.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Për arritjen e objektivave të programit të studimit si në aspektin e të nxënit dhe të punësimit, është e nevojshme një aktualizim dhe një përshtatje me e madhe praktike e strukturës së programit, siç është përmendur në kriteret e mësipërme  (Kriteri 5, Standarti II.1).
<b>Kriteri 3.</b> Planin mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.  Programi Profesional Marketing i Produktit Bujqësor është i përbërë prej 19 Modulesh dhe provimi final, nga ku 5 module jepen në semestrin e I-rë të vitit të I-rë, 5 module në semestrin e II-të të vitit të I-rë, 5 module në semestrin e III-të, viti i II-të, si dhe 4 module në semestrin e IV-të, viti i II-të. Më specifikisht këto module janë:  <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Baza të ekonomisë</li> <li>2- Informatikë e zbatuar</li> <li>3- Menaxhim agrobiznesi</li> <li>4- Baza të kontabilitetit</li> <li>5- Gjuhë e huaj (Anglisht)</li> <li>6- Sipërmarrje dhe drejtim i biznesit të vogël</li> <li>7- Ekonomi bujqësore</li> </ol>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

- 8- Baza të marketingut
- 9- Praktikë mësimore
- 10- Gjuhë e huaj (Greqisht)
- 11- Ekstension bujqësor
- 12- E drejtë biznesi
- 13- E-marketing
- 14- Marketing agrar
- 15- Ccmimet e produkteve bujqësore
- 16- Mbledhje e përpunim të dhënash
- 17- Komunikim në biznes
- 18- Politika të menaxhimit të agrobiznesit
- 19- Praktikë profesionale
- 20- Provimi final

Programi Profesional Menaxhim i Fermës Bujqësore ka gjithashtu 19 module dhe 1 provim final, të ndara në 5 module në semestrin e I-rë të vitit të I-rë, 5 module në semestrin e II-të të vitit të I-rë, 5 module në semestrin e III-të të vitit të II-të, si dhe 4 module në semestrin e IV-të të vitit të II-të. Me specifikisht modulet janë:

- 1- Baza të ekonomisë
- 2- Informatikë e zbatuar
- 3- Menaxhim agrobiznesi
- 4- Baza të kontabilitetit
- 5- Gjuhë e huaj (Anglisht)
- 6- Sipërmartje dhe drejtim i biznesit të vogël
- 7- Ekonomi bujqësore
- 8- Menaxhim i burimeve njerëzore
- 9- Praktikë mësimore
- 10- Gjuhë e huaj (Greqisht)
- 11- Ekstension bujqësor
- 12- E drejtë biznesi
- 13- Drejtim ferme
- 14- Baza të prodhimit bimor
- 15- Fitotekni
- 16- Mbledhje e përpunim të dhënash





	<p>17- Menaxhimi i teknikës bujqësore</p> <p>18- Politika të menaxhimit të agrobiznesit</p> <p>19- Praktikë profesionale</p> <p>20- Provimi final</p> <p>19.3 - <i>PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i></p> <p>19.1 - <i>Plani mesimor 2019-2020.pdf</i></p> <p>19.2 - <i>2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i></p> <p>19.4 - <i>2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktikë (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Programi i studimit ka mangësi për sa i përket raportit të formimit teorik me atë praktik. Përveç moduleve të praktikës profesionale të shpërndarë në dy semestra (Semestri II dhe Semestri IV), aftësimi praktik mungon.</p> <p>Më specifikisht, Programi Profesional Menaxhim i Fermës Bujqësore, bazuar në planin mësimor 2020-2021 si dhe planin mësimor 2019-2020, përmban 170 orë praktikë nga 1200 orë total në auditor, <b>ku në përqindje është 14%.</b></p> <p><b>Kjo ndarje është nën minimumin ligjor prej 25% të përcaktuar në VKM Nr. 185. Dt 25.3.2021 (Tabela 1.1. e Shtojcës 1).</b></p> <p>Për sa i përket Programit Profesional Marketing i Produktit Bujqësor, ka mospërputhje në ndarjen e ngarkesës së krediteve ECTS dhe ngarkesës në auditor (referohu Kriterit 3 të Standardit II.1).</p> <p>Sidoqoftë, edhe në këtë rast, aftësimi profesional dhe praktika përbëjnë 20% ose 240 orë të ngarkesës në auditor, që edhe në këtë rast është më pak se kërkesa ligjore e VKM Nr. 185. Dt 25.3.2021.</p> <p>19.1 - <i>Plani mesimor 2019-2020.pdf</i></p> <p>19.3 - <i>PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i></p> <p>VKM Nr. 185. Dt 25.3.2021</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Për arritjen e objektivave formues dhe orientimin drejt tregut të punës, është e nevojshme që programi të rishikohet si në aspektin formues përmes aktualizimit pëmbajtësor të moduleve ashtu edhe në raportin teori-praktikë.</p> <p>19-1 - <i>Plani mësimor 2019-2020</i></p> <p>19.3 - <i>PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i></p> <p>19.2 - <i>2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i></p> <p>19.4 - <i>2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

**Standardi II.3**

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetet e tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL vërehet se programi i studimit Agrobiznes në të dyja profilet “Menaxhim i fermës bujqësore” dhe “Marketing i produktit bujqësor”, përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e lëndëve sipas strukturës së planit të studimit.  <i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i> <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i> <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i> <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL si dhe gjatë takimeve kryer në institucion gjatë vizitës së GVJ, programi i studimit në të dyja profilet ka nevojë të aktualizohet jo vetëm me kërkesat e punëdhënësve, por dhe me zhvillimet politike dhe globale.  <b>Proceset integrale të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian duhet të jenë në fokus të programeve studimore, pasi edhe legjislacioni dhe politikat bujqësore shqiptare janë të bazuara në dhe po përafrohen gjithënjë e më tepër me politikat bujqësore të Bashkimit Europian.</b>  Gjithashtu, temat që përmbajnë syllabuset duhet të përditësohen me zhvillimet e bujqësisë në Shqipëri dhe në botë. Syllabuset e lëndëve agronomike (fitoteknike p.sh.) përmban njohuri rreth Orizit, Duhanit, Thekrës, Liloliumit etj, të cilat mbillen tashmë shumë rrallë dhe në sipërfaqe të limituara në Shqipëri, dhe që nuk zënë një peshë të rëndësishme në ekonominë shqiptare, ndërkohë që produkte me rëndësi të madhe për ekonominë shqiptare dhe që zënë peshën më të madhe të eksporteve siç janë perimet (domate, kastravec, etj), Bimë Aromatike dhe Mjekësore (BAM), apo edhe frutat nuk janë përfshirë fare në programin mësimor. Duke qenë se perimet, frutat, produktet blegtorale janë të destinuara direkt për tregun vendas dhe ndërkombëtar, atëherë edhe lëndët që kanë të bëjnë sidomos me marketingun do të kishin më shumë vlerë praktike për të ardhmen e studentëve, nisur dhe nga analizat e tregut që janë përgatitur në kuadër të këtij procesi akreditimi.  <i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i>





	<p>19.3 - <i>PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  19.2 - <i>2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  19.4 - <i>2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i>  16. - <i>studim tregu per programin profesional.pdf</i>  17. - <i>MBLEDHJE TE DHENASH - Studimi i tregut i vazhdueshem.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Përmbajtja e moduleve është më tepër në aspektin teorik, ku tematika nga konteksti shqiptar janë të pakta.</p> <p>Është e rekomandueshme që lëndët e profilit bujqësor të përmbajnë sa më shumë shembuj dhe raste nga bujqësia Shqiptare.</p> <p>Referuar vizitës në Institucion, gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët, u zotua që orët praktike do marrin një rëndësi më të madhe duke vënë në përdorim infrastrukturën e institucionit në Shën Vlash të Durrësit.</p> <p>Stafi akademik i institucionit u zotua se orët praktike sidomos për modulet Fitotekni, Baza të prodhimit bimor, drejtim ferme do bëhen në pjesën më të madhe në terren.</p> <p><i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Siç është përmendur dhe më lart, përmbajtja e moduleve është më tepër në aspektin teorik. Megjithatë, seminarët përbëjnë një platformë të përshtatshme për ndërveprimin mes studentëve, e cila favorizohet edhe nga numri i vogël i studentëve.</p> <p><i>19-1 - Plani mësimor 2019-2020</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Edhe pse programi i studimit ka shumë pak kohë që ofrohet edhe në kushtet e pandemisë, KU Logos ka bërë një punë shumë të mirë në lidhje me vendosjen e bashkëpunimeve të ndryshme me aktorë privat, si dhe hartimin e instrumentave të vlerësimit dhe ndjekjes së praktikave.</p> <p>Siç është përmendur dhe më lart, GVJ sugjeron që praktika profesionale të zgjerohet dhe të i jepet një hapësirë më e madhe, e cila shkon në linjë me kërkesat ligjore për raportin 50:50.</p> <p><i>34. - Marreveshjet e praktikës.pdf</i>  <i>MFB Logos Formular i miratimit te praktikës nga Departamenti.doc</i>  <i>MFB Logos Relacion mbi zhvillimin e Praktikës.doc</i>  <i>MFB Raport vleresimi nga mbikqyresi i praktikës.doc</i>  <i>MFB Vleresimi i pedagogut udheheqes .doc</i>  <i>MPB Logos Formular i miratimit te praktikës nga Departamenti.doc</i></p>

	MPB Logos Relacion mbi zhvillimin e Praktikes.doc MPB Vleresimi i pedagogut udheheqes.doc MPB, Raport vleresimi nga mbikqyresi i praktikes.doc			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	KU Logos ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka zhvilluar mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, duke patur parasysh edhe situatën pandemike të dy viteve të fundit nëpërmjet formularëve të vlerësimit. Mekanizmat e monitorimit të cilësisë së mësimdhënies janë parashikuar dhe rregulluar në një sërë dokumentash dhe rregulloresh, duke filluar nga Statuti i KU Logos (Neni 8 (1) ku vleresohet dhe garantohehet sigurimi i brendshëm i cilësisë në Kolegjin Universitar); (Neni 9 mbi këshillin e etikës, ku ka edhe pjesëmarrjen e studentëve); (Neni 11 (b) mbi Rektoratin, i cili merr në analizë zhvillimin e procesit mësimor në auditor); (Neni 17, Pika 6 (b) ku njësi bazë merr masa organizative dhe monitoruese për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe kërkimor nga punonjësit e njësisë bazë); Neni 39 (d) mbi studentët ku i lind e drejta të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të KU Logos. Rregullorja për sigurimin e cilësisë është një dokument tjetër që mundëson mekanizma për monitorimin e cilësisë. Në Nenin 7 pika 1 (a dhe b) parashikohet puna e njësisë së sigurimit të cilësisë e cila kryen veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi monitorim sistematik i respektimit nga KU "LOGOS" të kornizës ligjore dhe rregullatore si dhe të kriterëve të vlerësimit të studentëve; Në pikën 2 të Nenit 7 (b), parashikohet vlerësim i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien; c) vlerësim i veprimtarisë kërkimore-shkencore;

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>Gjithashtu, rregullorja e programit (Neni 25) parashikon mekanizma monitorimi ku studentët duhet të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon për të gjitha çështjet akademike dhe veprimatrinë e programit të studimit profesional 2-vjeçar “Agrobiznes me Profile” në Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor.</p> <p>Sigurimi i cilësisë dhe ngritja e strukturave të posaçme për të kryer funksionin e monitorimit të cilësisë në mësimdhënie është parashikuar edhe në rregulloren e përgjithshme të institucionit (Neni 127 dhe 128).</p> <p>Formularët e vlerësimit (Dok 41.1) janë gjithashtu një mekanizëm ku studentët shprehin vlerësimin e tyre për mësimdhënien strukturuar në shkallë Likert me 5 nivele.</p> <p>2. - <i>Statuti i KU “LOGOS”.pdf</i>  5. - <i>Rregullorja e përgjithshme e KU “LOGOS”.pdf</i>  7.2. - <i>Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i>  57. - <i>VLERESIMET E STAFIT.pdf</i>  8.1. - <i>Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-2019.</i>  8.2. - <i>Politika-e-Cilesise 2019-KULOGOS.pdf</i>  9. - <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i>  38. - <i>ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT.pdf</i>  40.1. - <i>Formulari TIP - sem1, 20-21, Microsoft Forms.pdf</i>  40.2. - <i>KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-pedagog.pdf</i>  41. 1. - <i>KU LOGOS-Formular vleresimi per mesimin ne distance 2020 studenti.pdf</i>  41.2 <i>KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>  41.2. - <i>KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>  55.3. <i>SA- udhezim per politiken e vleresimit ne distance.pdf</i>  55.4. <i>Rektorati-urdher - platforma digjitale.pdf</i>  55.5. <i>Udhezues per mesimin ne distance per studentet-2020.pdf</i>  55.6. <i>Rektori-mesazh-per vleresimin.pdf</i>  55.7. <i>SA -vendim nr 10 -politika e arsimit ne distance.pdf</i>  55.11. <i>SA-Lidhja 2 TABELA PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË MËSIMIT DHE PROVIMEVE (1).doc</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>KU Logos ka përfshirë të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies siç janë janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura, të paraqitura në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse.</p> <p>19-1 - <i>Plani mësimor 2019-2020</i>  19.3 - <i>PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  19.2 - <i>2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  19.4 - <i>2020-2021 SYLLABUS – SHQIP. Pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Nisur dhe nga situata e pandemisë shkaktuar nga Covid19, personeli akademik ka përdorur metoda alternative për mësimdhënie, të cilat institucioni i ka sanksionuar dhe rregulluar edhe formalisht me manuale për mësimin në distancë.</p> <p><i>55.5. Udhezues per mesimin ne distance per studentet-2020.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar CV-ve, personeli akademik është përgjithësisht i kualifikuar dhe kompetent në shpjegimin e njohurive sipas ekspertizës që zotërojnë.</p> <p>Megjithatë, stafi akademik për lëndët e profilit të menaxhimit të fermës dhe marketingut të produktit bujqësor është në pjesën më të madhe me profil menaxhimi por jo bujqësor.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe nga bisedat gjatë vizitës në institucion, staf akademik ka mundësinë të shkëmbejë eksperiencë me kolegët e tyre në institucione të tjera partnere me të cilët KU Logos ka partneritet bashkëpunimi siç janë Universiteti i Korçës apo Universiteti Bujqësor i Tiranës, të cilët kanë eksperiencë më të madhe në fushën e bujqësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	
<p><b>Standardi III.2</b></p> <p><b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në vizitën e kryer nga GVJ në KU Logos, procesi mësimor mund të realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe shumë cilësore. Ndërkohë procesi praktik ka gjithashtu mundësi të kryhet në mjedise të përshtatshme praktike siç është ferma në Shën Vlash në Durrës.</p> <p>Sidoqoftë duhet të kemi parasysh që situata pandemike nga Covid 19, ka bërë që si procesi mësimor teorik, por më tepër ai praktik të mos realizohet në kushte normale por online.</p> <p><i>Ref. Vizita në IAL</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në</p>	<p>Bazuar në diskutimet me stafin akademik dhe në vizitën e GVJ-së në mjediset e institucionit KU Logos, infrastruktura IT për stafin akademik dhe studentët është e përshtatshme dhe e konsoliduar. Stafi akademik dhe studentët përdorin platformat online edupage dhe MS</p>			



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	<p>Teams.</p> <p>39.1. - <i>Edupage.pdf</i></p> <p>39.2. - <i>Manual Edupage - Pedagoget - Reduktuar Mesimi Online.pdf</i></p> <p>39.3. - <i>Njoftimet dhe komunikimet për trajnimet e platformave të reja digjitale.pdf</i></p> <p>39.4. - <i>Office 365.pdf</i></p> <p>39.5. - <i>Manuali i përdorimit të Office 365 Teams për Lektorët e Kolegjit Universitar Logos.pdf</i></p> <p>39.6. - <i>Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	<p>Referuar syllabuseve të paraqitura në planin mësimor 2020-2021, literatura bazë dhe mbështetëse është në shumë raste e bazuar në leksione të përmbledhura, e vjetëruar si dhe e papërshtatëshme për nivelin e programit të studimit (p.sh. Në modulën Fitotekni, literatura e rekomanduar është grup autorësh Botim i viti 1987; në modulën Çmimet e produkteve bujqësore, literatura bazë dhe e rekomanduar nuk ka një vit botimi; në modulën Baza të Ekonomisë, literatura e rekomanduar Mankië 2003,2005, apo Variant 2000 janë të një niveli shumë të avancuar).</p> <p>19.2 - <i>2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i></p> <p>19.4 - <i>2020-2021 SYLLABUS - SHQIP. Pdf</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Stafi akademik dhe studentët kanë akses në disa faqe online që janë të hapura për publikun e gjerë siç janë faqja e FAOs, Bankës Botërore, Komisionit Europian apo Departamentit Amerikan të Bujqësisë.</p> <p>Këto faqe interneti nuk ofrojnë informacion didaktik dhe shkencor por informacion të përgjithshëm rreth temave bujqësore që ndodhin në botë.</p> <p>45.2. - <i>adresa elektronike agrobiznes.pdf</i></p> <p>Nga vizita dhe biseda në bibliotekën e institucionit GVJ- së iu komunikua se institucioni është në proces të përmirësimit të aksesit në literaturë dhe shërbime të tjera akademike nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë në Greqi.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Bazuar në vizitën e GVJ-së në mjediset e institucionit KU Logos, infrastruktura laboratorike dhe didaktike për studentët është moderne, e përshtatshme dhe e konsoliduar. Mund të thuhet që infrastruktura e institucionit është nga më të mirat në vend.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Duke u nisur dhe nga pandemia e shkaktuar nga Covid19, personeli akademik dhe studentët përdorin në masë të gjerë platforma online. MS Teams është një nga platformat që përdoret gjerësisht në institucion.</p> <p>39.1. - <i>Edupage.pdf</i></p>

	<p>39.2. - <i>Manual Edupage - Pedagoget - Reduktuar Mesimi Online.pdf</i></p> <p>39.3. - <i>Njoftimet dhe komunikimet për trajnimet e platformave të reja digjitale.pdf</i></p> <p>39.4. - <i>Office 365.pdf</i></p> <p>39.5. - <i>Manuali i përdorimit të Office 365 Teams për Lektorët e Kolegjit Universitar Logos.pdf</i></p> <p>39.6. - <i>Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	<p>KU LOGOS ka ngritur strukturën e NJSBC, e cila ka funksion kryesor sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo njësi është në nivel institucional, realizon pyetësorët e studentëve, përpunimin dhe analizën e tyre, si dhe harton raportin në nivel institucional, të cilin më pas e paraqet në senat.</p> <p>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë për PS DP AGB.</p> <p><i>8.1. - Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-2019.pdf</i></p> <p><i>8.2. - Politika-e-Cilesise 2019-KULOGOS.pdf</i></p> <p><i>13. - Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilesise së Institucionit dhe programeve të studimit (1).</i></p> <p><i>57. - VLERESIMET E STAFIT.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	<p>Njësia bazë konkretisht departamenti i Agrobiznesit mbështet dhe nxit proceset të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit. Por GVJ gjykon që duhet të bëhet më shumë për të krijuar një praktikë që ka për qëllim përmirësimin e programit nga një perspektivë multi stakeholder ( student, partner biznesi, pedagogë etj).</p>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se KU LOGOS, angazhon lektorë në procesin mësimor, si lektorë të ftuar apo kërkues shkencorë jashtë institucionit për shkëmbim të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)






<p>e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>eksperiencave. Por vihet re që në vitin e parë të aplikimit një numër i konsiderueshëm lektorësh të jashtëm janë përfshirë në zhvillimin e PS. Po kështu pjesa më e madhe e titullarëve në lëndët e përfshira në DP AGB janë pedagogë më kohë të plotë në IAL të tjera. KU LOGOS duhet të bëjë përpjekje për të balancuar stafin PAE me stafin akademik PAK sipas dispozitave ligjore sepse në të kundërt vihet në pikëpyetje qëndrueshmëria e PS. Po kështu në syllabuset e dorëzuara pjesa më e madhe e stafit titullar i moduleve nuk i përket kategorise Profesor.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Sipas RVB, Përgjegjësit e departamenteve me anë të verifikimeve në auditorët e mësimdhënies në rastin konkret nëpërmjet monitorimit në auditorë online, vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies duke raportuar më tej pranë dekanit. GVJ është e mendimit, se ky kriter përmbushet duke pasur parasysh që metodat inovative janë testuar në kushtet e pandemisë dhe për të është ofruar edhe feedback si nga pedagogu por edhe nga studentët për problematika të hasura.</p> <p><i>40.1. - Formulari TIP - sem1, 20-21, Microsoft Forms.pdf</i>  <i>40.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-pedagog.pdf</i>  <i>41. 1. - KU LOGOS-Formular vleresimi per mesimin ne distance 2020 studenti.pdf</i>  <i>41.2 KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>  <i>41.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënien, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p><i>40.1. - Formulari TIP - sem1, 20-21, Microsoft Forms.pdf</i>  <i>40.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-pedagog.pdf</i>  <i>41. 1. - KU LOGOS-Formular vleresimi per mesimin ne distance 2020 studenti.pdf</i>  <i>41.2 KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>  <i>41.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi III.4**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton nga takimi me studentët, se ata informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për: programin e lëndës, format alternative të vlerësimit si dhe detyrimet që studentët kanë.</p> <p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti. GVJ gjykon që ka një diversitet sa i përket mënyrës së kontrollit të njohurive në lëndë të ndryshme që ofrohen në kuadër të PS DP AGB. Duke marrë në shqyrtim syllabuset e lëndëve vihet re që edhe pse ka një diversitet në format e kontrollit të njohurive, GVJ gjykon që format e ndryshme nuk janë konform rregullit 50/50 që parashikohet në VKM nr 185 datë 25.03.2021 ndryshim i VKM 41.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Sipërmarrja dhe biznesi I vogël Dr Ledia Sulaj</b> Kontrolli i njohurive testi përfundimtar 50% , dosja praktike projekt 30%, frekuentim seminar 20%</li> <li>• <b>Ekonomi Bujqësore Olda Cico Donika Nano Msc</b> Provimi përfundimtar 50%, Projekte deri 15%, Frekuentimi 10%, Teste 20%</li> <li>• <b>Menaxhimi i Burimeve Njerezore Ledia Sula</b> Kontrolli i njohurive testi përfundimtar 50%, dosja praktike projekt 30%, frekuentim seminar 20% Literatura nuk është e 5 viteve të fundit.</li> <li>• <b>Lenda praktike mesimore Enxhi Marku</b> 90% kontroll i vazhdueshëm çfarë nënkuptohet me këtë lloj kontrolli, në këtë lëndë nuk specifikohen kompetencat e fituara nga ana e studentit. Nëse ka të ftuar në realizimin e saj.</li> <li>• <b>Bazat e Marketingut Olda Cico-Enxhi Marku</b> 10% frekuentim, 30% provim i ndërmjetëm dhe 60% provim përfundimtar, literature nuk është e 5 viteve të fundit.</li> <li>• <b>Menaxhim Agrobiznesi Ilir Sosoli</b> 10% frekuentim, 30% provim i ndërmjetëm dhe 60% provim përfundimtar,</li> <li>• <b>Bazat e kontabilitetit Jehona Germizi</b></li> </ul>



10% frekuentim, 30% provim i ndërmjetëm dhe 60% provim përfundimtar,

- **Informatike e zbatuar Prof Dr Ilia Ninka-Lysien Ali**

Provimi 50%, Projekte deri 15%, Frekuentimi 10%, Teste 20%

- **Bazat e Ekonomisë Dorjan Marku Dr PAK**

10% frekuentim, 30% provim i ndërmjetëm dhe 60% provim përfundimtar,

- **Gjuha Angleze Pse është përfshirë titullari Prof Asoc Dr Marsela Harizaj**

10% frekuentim, 30% provim i ndërmjetëm dhe 60% provim përfundimtar,

- **Informatikë e zbatuar Donald Elmazi PhD Literatura nuk është e 5 viteve të fundit**

Provimi 50%, Projekte deri 15%, Frekuentimi 10%, Teste 20%

- **Fitotekni Prof Asoc Dr Gjergji Mero**

Seminar 50, laborator 30, projekt 20, duhet të specifikohet më qartë kontrolli i njohurive, cili është roli i provimit përfundimtar dhe si është i organizuar

- **Marketing Agrar Olda Cico Dr**

Provimi 50%, Projekte deri 15%, Frekuentimi 10%, Teste 20%

GVJ gjykon që lënda e Marketingut Agrar bashkë me lëndën e Bazave të Marketingut si dhe atë të Çmimeve të Produkteve Bujqësore mund të shkrihen në një duke pasur parasysh llojin e diplomës dhe studentët që targeton ky program studimi. Konceptet të bazave të marketingut mund të bëhen në nivel aplikativ në kushtet e produkteve bujqësore dhe në sektorin bujqësor në përgjithësi. Duke pasur parasysh edhe zhvillimet e fundit në tregun e produkteve bujqësore, programi i studimit mund të përmirësohet duke integruar lëndë të tjera praktike në fushën e marketingut.

Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shoqëruar u konstatua se studentët janë të informuar me të drejtat dhe detyrimet e tyre, për këtë program studimi. Ata disponojnë rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi. Janë të mirë

	<p>informuar për mënyrat e vlerësimit, detyrimet gjatë vitit dhe provimin përfundimtar nga pedagogët e lëndëve.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ vlerëson që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi sipas rregulloreve të KU-LOGOS, rregullores së FE si dhe rregullores së programit të studimit DP AGB.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Sa i përket vlerësimit në distancë të kryer gjatë pandemisë, KU LOGOS, e institucionalizoi këtë proces të paraqitur në Udhëzimin nr 4, datë 11.05.2020 Për Politikën e Vlerësimit në Distancë. Në këtë udhëzues janë përcaktuar shumë qartë dhe në formë shteruese përgatitjet që duhet të bëjë stafi në drejtim të :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Provimit me gojë online nëpërmjet videokonferencës (i cili zgjat 15 min për çdo student, në udhëzues përcaktohen edhe elementë të hartimit të pyetjeve të tezës)</li> <li>2. Testeve me shkrim nëpërmjet platformave digjitale</li> <li>3. Provime të kryera nga shtëpia si rastet studimore, esete, projektet etj</li> <li>4. Dosjeve elektronike të punimeve të kursit</li> <li>5. Vlerësimit të veprimtarisë laboratorike virtuale</li> <li>6. Vlerësimi i praktikës profesionale online</li> </ol> <p><i>55.2.. Rektori-urdher - platforma digjitale (3).pdf</i>  <i>55.3. SA- udhezim per politiken e vleresimit ne distance.pdf</i>  <i>55.4. Rektori-urdher - platforma digjitale.pdf</i>  <i>55.5. Udhëzues per mesimin ne distance per studentet-2020.pdf</i>  <i>55.6. Rektori-mesazh-per vleresimin.pdf</i>  <i>55.7. SA -vendim nr 10 -politika e arsimit ne distance.pdf</i></p> <p>KU LOGOS ka zhvilluar edhe nje proces folloë up për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e mësimin në kushtet online si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët.</p>

40.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-pedagog.pdf  
41. 1. - KU LOGOS-Formular vleresimi per mesimin ne distance 2020 studenti.pdf  
41.2 KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf  
41.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf

Në rregulloren e departamentit të Agrobiznesit në KU-LOGOS, në faqen 14-16 paraqitet procedura institucionale për zhvillimin e provimit Në rregulloren e departamentit, paraqiten të gjithë elementë që lidhen me procesin e provimit, për programin e studimit në fjalë. Në këtë rregullore në pikën 13 paraqitet që: Kontrolli i dijeve për secilën lëndë realizohet duke përdorur skemën e vlerësimit 30-10-60. 30% e vlerësimit përbëhet nga testi i ndërmjetëm që zhvillohet javën e 7-8 të semestrit, 10% vlerësim për pjesëmarrjen në seminare gjatë vitit dhe 60% përbën vlerësimin semestral në formën e një testi. Ashtu si është përmendur edhe me sipër diploma profesionale ka karakter praktik dhe ky element duhet të jetë i përshtatur edhe në formën e kontrollit të dijeve. Megjithatë në takimet e GVJ me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi u përmend që provimet e ndërmjetme zhvillohen në formën e detyrave praktike, GVJ rekomandon që të institucionalizohet një praktikë e tillë.

Hyrja në provim e studentëve bëhet pasi kanë garantuar kriterin e pjesëmarrjes në 70% të orëve të parashikuara në programin e lëndëve. Në provimin semestral asistojnë dy pedagogë. Në rregullore paraqitet që rezultatet e provimit afishohen pas 5 ditësh nga dita e kryerjes së provimit (ditë pune). Tezat printohen dhe sekretohen nga sekretaria mësimore para fillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i bëhet me shkrim përgjegjesit të departamentit jo më vonë se 24 orë nga marrja e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve bën verifikimet me pedagogun e lëndës. Nëse kërkesa për rivlerësim nuk gjen mbështetje nga pedagogu i lëndës, përgjegjësi i departamentit krijon një grup Ad-hoc. Eksistenca e rregullores në drejtim të menaxhimit të ankesave institucionalizon procesin dhe për rrjedhojë edhe cilësinë e marrëdhënies me studentin. Vendimi i vlerësimit ad-hoc është përfundimtar. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit. Nga takimi i GVJ me studentë që ndjekin programin e studimit diplomë profesionale në **Diplomë Profesionale në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore"** nuk rezultonin

	problematika lidhur me këtë proces.  <i>RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i> 7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf 9. - Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
<b>Standardi III.5</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.	Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve. Në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve.			
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Megjithatë GVJ gjykon që lëndët e propozuara në PS DP AGB nuk janë reflektim direkt i nevojave që mund të plotësohen për nxënësit që inbarojnë shkollën e mesme. GVJ rekomandon rishkim të programit të studimit jo vetëm në terma të lëndëve të përfshira por edhe mënyrës së ofrimit të dijeve duke pasur parasysh që diploma profesionale duhet të ketë një raport midis teorisë dhe praktikës në raportet 50/50. Mënyra se si janë ndërtuar syllabuset targetojnë studentë të ciklit të parë të studimeve universitare BSc.  <i>7.2.Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i> <i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i> <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i> <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i> <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i> <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i> <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e	GVJ gjykon duke pasur parasysh edhe komentet e shprehura më sipër në lidhje me lëndët e përfshira në PS dhe ndërtimin e tyre që ky kriter nuk plotësohet. Mësimdhënia nuk është e bazuar mbi bazën e kompetencave.			

<p>aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>KU-LOGOS duhet të parashikojë partnerët e biznesit dhe aktivitetet që studentët duhet të zhvillojnë në to në kuadër të plotësimit të një dosje praktike që duhet të përbëjë 50% të detyrimeve të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Departamenti i Agrobiznesit harton një analizë vjetore për ecurinë e programit të studimit por nuk ka një analizë të mirëfilltë për kompetencat që fitohen në nivel profesionale për problemet që ka programi i studimit.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Procedurat janë të paraqitura në rregulloren e Fakultetit Ekonomik (FE) (në kapitullin 10). Në rregulloren e FE paraqitet e detajuar procedura e diplomimit për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve. GVJ rekomandon që në këtë kapitull të reflektohen edhe elementë të diplomimit të studentëve për ciklet e programeve profesionale. Detyrimet e institucionit në lidhje me diplomimin e studentëve janë të paraqitura edhe në statutin e KU LOGOS.</p> <p>KU LOGOS mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik. GVJ u konsultua me regjistrin për programin e studimit dhe nuk evidentoi pasaktësi.</p> <p>Gjitashtu në nenin 23 të rregullores së Departamentit të Agrobiznesit paraqiten kriteret dhe procedurat për lidhur me procesin e diplomimit. Procedurat për mbajtjen e të dhënave të studentëve para dhe pas diplomimit paraqiten edhe në rregulloren e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>6.2. - RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGRUBIZNESI.pdf</i>  <i>7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i>  <i>9. - Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i>  <i>- Statuti i KU "LOGOS".pdf</i>  <i>5. - Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke</p>	<p>Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e</p>

<p>garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>saj. Ky proces është tashmë i konsoliduar në KU LOGOS. Në rregulloren e Fakultetit Ekonomik, në Rregulloren e Përgjithshme të të KU LOGOS si dhe në Departamentin e Agrobiznesit paraqiten rregullat për procesin e diplomimit. Megjithatë si është paraqitur dhe më sipër këto rregulla duhet të konsolidohen edhe për diplomën profesionale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë ASCAL vihet re një praktikë shumë e mirë për vlerësimin e njohurive në të gjithë komponentët e saj për periudhën e pandemisë kur proceset mësimore u zhvilluan online. GVJ mendon që një praktikë e tillë pozitive mund të përfshijë edhe proceset e diplomimit për programin e studimit në fjalë.</p> <p>5. - Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</p> <p>7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<p><b>Standardi IV.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Referuar informacionit të konsultuar në sistemin AMS të ASCAL, rezulton se KU LOGOS, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentash të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik si: Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, Kriteret e vlerësimit për pune si staf akademik, Formular Aplikimi per Staf Akademik, ndërkohë GVJ gjatë vizitës në institucion me stafin e burimeve njerëzore, u konsultua me një praktikë konkrete të zbatimit të këtyre procedurave të sanksionuar në aktet rregullatore të KU LOGOS.</p> <p>GVJ referuar dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS, konstaton se KU LOGOS ka hartuar një procedurë në të cilën</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit. GVJ konstatoi gjithashtu mekanizma të bërjes publike të këtyre kriterëve.</p> <p><i>Dokument 59.-Paketë rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personel akademik me kohë të plotë (Shembull Departamenti i Agrobiznesit) (1).pdf</i></p> <p><i>Dokument44. - Formati i dosjes personale te stafit.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se KU LOGOS, në lidhje me PS DP Agrobiznes, disponon të dhënat për çdo semestër, për çdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij, PAE apo PAK. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit, është përgjegjësi i Departamentit të Agrobiznesit, e cili ka gradën shkencore” Doktor i Shkencave”.</p> <p><i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga të dhënat e departamentit të Agrobiznesit rezulton që për stafin e angazhuar në të dy vitet akademike për këtë program studimi, 55% e stafit është PAE ndërsa rreth 45% janë PAK duke qenë në kundërshtim me rregullin 70% PAE dhe 30% PAK. Megjithatë, KU LOGOS ka lidhur një marrëveshje me MASR "Për përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë në njësitë bazë në kolegjin universitar "Logos" në datën 10.07.2019.</p> <p>Sipas nenit 3 të kësaj procedure, "Nëse Kolegji Universitar "Logos", për të paktën tri vite akademike, nuk ka më shumë se gjashtëqind studentë dhe përmbush kushtet e kodit të cilësisë të procesit mësimor, mund të mos plotësojë kushtet e pikës 4, të nenit 25 të Ligjit nr 80/2015" Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ku parashikohet se departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Në pikën 2 të nenit të 3 të marrëveshjes, paraqitet që në Departamentin e Menaxhim Biznesi do të jenë të paktën 5 pedagogë me kohë të plotë, minimalisht 2 prej të cilëve duhet të zotërojnë gradën shkencore ose titull akademik. Në çdo rast, personeli akademik me kohë të plotë në secilën njësi bazë duhet të mbulojë 70% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Sipas CV të dorëzuar pranë ASCAL, 8 anëtarë të stafit kanë</p>

	gradën Doktor, 2 Prof. Assoc. Dr. dhe 5 janë Master i Shkencave. Nga këto, 4 anëtarë të stafit (të gjithë me kohë të pjesëshme) kanë marrë gradën shkencore apo kanë studiuar në universitet me profil bujqësor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>KU LOGOS rezulton se mbështet stafin e vet për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat inovative, pjesëmarrjen në konferencat që KU LOGOS organizon, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta. Nga takimet me stafin akademik të PS DP Agrobiznes, rezulton se KU-LOGOS, organizon trajnime/ ose leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies, si shembull përmendim: Manual përdorimi për softëare Edupage për mësimin online për pedagogët.</p> <p>Në platformën "Edupage", e cila është një metodë inovative ku i krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshihen të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e KU-LOGOS GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimin të PS DP në AGB. Nga këto statistika identifikohet se KU LOGOS, disponon 4 auditorë mësimore me një sipërfaqe prej 35-50 metër katror për seminarët dhe 2 salla leksionesh me kapacitet prej 120 vendesh.  <i>(Campus Building overview)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të PS DP në AGB, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, dhe videoprojektor. Institucioni realizon mbulim të vazhdueshëm me internet të këtyre hapësirave, si domosdoshmëri për përdorimin e teknologjive të informacionit si dhe metodave alternative të mësimdhënies. Megjithëse këto facilitete nuk janë përdorur nga studentët për shkak të zhvillimit të mësimin online ato sigurojnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<p>mbështetje të studentëve në realizimin e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Infrastructure expansion_AL.pdf</i></p> <p><i>Infrastructure Report 2020_AL.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht laboratorët e informatikës, sallat e leksionit dhe seminarit si dhe bibliotekën.</p> <p>Nga takimi me studentët konstatohet se studentët mund të shfrytëzojnë këto ambiente, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës dhe të objektivave të PS DP në AGB megjithëse ato nuk janë përdorur fizikisht në vitin akademik për shkak të pandemisë, studentët kanë marrë mbështetjen e nevojshme nga stafi i angazhuar direkt dhe indirekt me këtë program studimi.</p> <p><i>Infrastructure expansion_AL.pdf</i></p> <p><i>Infrastructure Report 2020_AL.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion të GVJ, ndër laboratorët që KU-LOGOS disponon, u evidentua laborator i Informatikës, i cili ka pajisjet e duhura hardëerike dhe softëerike që i nevojiten studentëve. GVJ rekomandon sigurimin e softëareve që mundësojnë realizimin e objektivave të PS sidomos në ato lëndë në të cilat bëhet e nevojshme përfshirja e teknologjisë si psh lënda E-Marketing.</p> <p><i>Campus buildings overview (Table)_AL.pdf</i></p> <p><i>Infrastructure Report 2020_AL.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Referuar PS në DP AGB, dhe vizitës në institucion, rezulton se studentët zhvillojnë praktikë profesionale si lëndë të veçantë, por syllabusi i kësaj lëndë është jo i plotë kështu që nuk mund të gjykojmë për cilësinë dhe përmbajtjen e saj. Përpos kësaj lënde studentët zhvillojnë edhe praktikë profesionale në një nga institucionet me të cilat bashkëpunon KU-LOGOS. Gjykojmë që, nisur nga natyra e PS dhe rolit të rëndësishëm praktik të saj, institucioni duhet të pasurojë listën e institucioneve me të cilat bashkëpunon. Po kështu në të gjitha syllabuset e konsultuara nuk paraqitet elementi praktik që është esencial për këtë PS si parashikohet në VKM nr 185 date 25.03.2021 ndryshim i VKM 41. Në përputhje me këtë VKM rekomandohet rishikimi i syllabuseve lidhur me kompetencat e përfuara nga studentët në nivel teorik dhe atë praktik.</p> <p>KU LOGOS disponon mjedise të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale në një nga kampuset e tij. Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në programin studimit në shqyrtim, studentët e zhvillonin praktikën në bizneset private me të cilat</p>




	IAL kishte marrëveshje bashkëpunimi. 34. - <i>Marreveshjet e praktikës.pdf</i> 35. - <i>RAPORT I PERFITIMEVE NGA MARREVESHJET E PRAKTIKES.pdf</i> 36. - <i>GRUPE TUTORATI AGROBIZNES.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
<b>Standardi IV.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	KU LOGOS vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Pavarësisht se PS DP AGB ka numër të vogël studentësh gjykojmë që hapësirat e ofruara janë të përshtatshme. Nga vizita në institucion u vu re prezenca e stafit të angazhuar dhe proaktiv në drejtim të sigurimit të marrëveshje të ndryshme me IAL brenda vendit dhe jashtë vendit sidomos në Greqi për pasurimin e titujve që lidhen me PS në fjalë. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin literaturë në mënyrë fizike dhe elektronike.  <i>45.3. - Rregullorja e bibliotekës Logos.pdf</i> <i>45.4. - Strategjia e bibliotekës.pdf</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Këto libra janë siguruar nga bashkëpunimet që ky institucion ka vendosur me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Korçës si dhe Universitetin Aristoteli në Thesalonikit në Greqi. Abonimi në revistën Agrobiznesi përbën një element pozitiv, megjithatë <b>GVJ rekomandon pajisjen me literaturë të karakterit praktik përveç atij teorik të përshtatshme për këtë program studimi.</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	KU LOGOS garanton akses të barabartë e pa pagesë në linkun online të bibliotekës. Gjithashtu institucioni ka akses pa pagesë në literaturën online në bibliotekën ndërkombëtare Questia Online Library. Nga vizita e GVJ në mjediset e bibliotekës dhe takimet me stafin përgjegjës u vu re proaktiviteti për të pasuruar bibliotekën nga marrëveshja me IAL të tjera jashtë vendit që kanë të njëjtin profil me PS në AGB. GVJ rekomandon një strategji të veçantë në pasurimin e bibliotekës kur bëhet fjalë për këtë program studimi sepse niveli praktik i kërkuar është i lartë dhe literatura duhet të pasurohet në këtë drejtim.			

	<b>GVJ sugjeron zbatimin e një plani të detajuar të përvitshëm, me propozim nga njësia bazë, për shtimin e fondit të bibliotekës dhe për pasurimin cilësor të saj më literaturë bashkëkohore për fushën e agrobiznesit dhe më veçanërisht për profilet marketing i produkteve bujqësore e menaxhim fermash.</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Referuar RVB por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin akademik të përfshirë, si dhe përmbytjes së syllabuseve rezultojn se në njësinë bazë nuk ka një plan të detajuar se si do të aplikohen aspektet praktike të secilit modul lënde dhe si do të zhvillohen ato në praktikë dhe për më tepër si do të implementohen në institucionet pritëse. Përveç raportit të praktikës dhe elementëve të tjerë që përfshihen në dosjen e praktikës së secilit student duhet të përfshihen edhe objektivat si dhe kompetencat e fituara nga praktika e zhvilluar në drejtim të profilit të zgjedhur nga studenti. <b>Gjithashtu GVJ rekomandon krijimin e një praktike për vlerësimin e praktikës së zhvilluar. Nga kjo praktikë IAL do të mund të përmirësojë aspekte të veçanta që lidhen me PS.</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	<b>GVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se IAL është e pajisur me një plan financiar, buxhetimin e të ardhurave dhe alokimin e tyre. KU LOGOS harton një raport financiar, ku jepet informacion rreth kostove.</b> GVJ sugjeron që në planin për mbështetjen financiare të ketë aktivitete më të detajuara të planifikuara për mbarëvajtjen e PS DPAGB, për të paktën një cikël të plotë studimi. Referuar planit të financimit të depozituar në sistemin AMS, GVJ konstaton se ky plan financimi duhet të jetë më i detajuar dhe të ofrojë informacion mbi elementët sipas kriterit 2, në nivel programor.			
<b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	GVJ referuar RVB, konstaton se çdo vit institucioni kryen auditim nga një kompani e certifikuar. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ai jep opinionin e tij të pavarur mbi situatën financiare të Kolegjit. Përveç auditimit të jashtëm KU LOGOS kryen dhe auditime të brendshme dhe i raporton në Bordin e Administrimit.  49.1 - <i>Projekt buxheti 2020-2024.pdf</i> 49.2. - <i>Raport i Auditimit 2019.pdf</i> 49.3 - <i>Realizimi Buxhetit 2018-2019-2020 - personeli.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	


**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit. Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis nga momenti i informimit për programet akademike për maturantët dhe deri pas përfundimit të studimeve nga ana e tyre. Kolegji pajis studentët me të gjithë materialet e nevojshme të informimit si broshura, fletpalosje, i adreson në faqen ëeb dhe i informon në lidhje me çdo mjet tjetër komunikimi. Nga vlerësimi rezulton që institucioni dokumenton praktikrat e shoqërimit të studentit nga hyrja në dalje.</p> <p><i>47.2. - Profili i KU "LOGOS" në portalin U-ALBANIA.pdf</i>  <i>48.1. - Rubrika e dedikuar studenteve nga plani strategjik 2018-2024.pdf</i>  <i>48.2. - Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i>  <i>48.3. - Broshura e "LOGOS" në shqip (2).pdf</i>  <i>48.4. - Broshura e "LOGOS" në anglisht.pdf</i>  <i>48.5. - Fletëpalosja e "LOGOS" në shqip.pdf</i>  <i>51.0. -Agrobiznesi POLITIKA E MARKETINGUT TE PROGRAMIT TE STUDIMIT FORMAT E TIJ TRANSPARENCA ME PUBLIKUN_docx.pdf</i>  <i>51.1 Pjesëmarrja në Panairret e Punës.pdf</i>  <i>51.2.Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i>  <i>51.3.4.KESHILLIMI I KARRIERES ONLINE</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Institucioni parashikon në rregulloren e KU LOGOS, në rregulloren e Fakultetit Ekonomik si dhe rregulloren e departamenteve përkatëse kriteret për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit. Më konkretisht për PS DP në AGB këto kriteret paraqiten në rregulloren e PS DP në AGB <i>KREU IV PRANIMI I STUDENTEVE Neni 21 Politika e pranimit</i></p> <p><i>1. Çdo vit akademik, për të ndjekur programin e studimit profesional 2-vjeçar "Agrobiznes me Profile" në Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor, pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia e Mali i Zi, dhe nga vende të tjera pasi kandidatët kryejnë procedurën e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit pranë Ministrisë së Linjës. Programi i studimit profesional 2-vjeçar "Agrobiznes me Profile" në Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor, synon të jetë një kurs i hapur për të gjithë maturantët qe kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe studentët që duan të ndjekin një program të dytë studimi në programet profesionale 2-vjeçare.</i></p>





	<p>Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurim nëse numri i kërkesave është më i madh se kuota e pranimit. 4. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës që nënkupton vlerësimin tërësor të treguesve të kandidatit. 5. Organizimi i konkursit të pranimit bëhet nga Fakulteti i Ekonomisë mbi bazën e kësaj Rregulloreje, Rregullores së brendshme të Fakultetit dhe të vendimeve të autoriteteve drejtuese të Institucionit.</p> <p><b>Megjithatë GVJ rekomandon që edhe pse ligji nuk parashikon aktualisht një kriter aksesues, duhet të vendosen kritere minimale për të aksesuar në një program të tillë studimi.</b></p> <p>5. - <i>Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</i></p> <p>6.1. - <i>Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf</i></p> <p>6.2. - <i>RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i></p> <p>7.2. - <i>Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Departamenti i Agrobiznesit , Zyra e Karrierës dhe Sekretaria mësimore vë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik dhe kalimin e studentëve nga një vit në vitin pasardhës, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme: rregullorja e KU LOGOS, rregullorja e FE, rregullorja e sekretarisë mësimore si dhe rregullorja e PS DP AGB.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga vlerësimi i faqes ëeb, nuk paraqiten kritere të detajuar për pranimin e studentëve në PS objekt i këtij vlerësimi si psh nota mesatare e përfundimit të shkollës së mesme, nëse shkollat e mesme profesionale bujqësore, ekonomike, hoteleri turizem kanë një prioritet të veçantë në kriteret e përzgjedhjes.</p> <p><a href="http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html">http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ rekomandon plotësimin e këtyre kriterëve për të siguruar rritjen e cilësisë në kandidatët e përzgjedhur për këtë PS.</p> <p>5. - <i>Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf</i></p> <p>6.1. - <i>Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf</i></p> <p>6.2. - <i>RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i></p> <p>7.2. - <i>Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i></p> <p>Gjithashtu Departamenti i Agrobiznesit informon studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit, me fletëpalosje, broshura dhe me çdo mjet tjetër komunikimi që KU LOGOS disponon- Po kështu studentëve u vihet në dispozicion edhe nr. kontakti, email edhe informacione të marra nga njësitë përgjegjëse si: sekretaria, zyra e karrierës dhe departamenti</p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe</p>

	<p>dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nëpërmjet platformës Eduplatform. Gjithashtu informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen është i aksesueshëm edhe në faqen Eëb për të informuar edhe studentët jashtë KU logos duke përmbushur kështu një detyrim ligjor. Grupet e tutoratit janë një tjetër organizim që ofron informacion studentëve në lidhje me programin e studimit.</p> <p>36. - <i>GRUPE TUTORATI AGROBIZNES.pdf</i></p> <p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës, një praktikë e tillë vihet re dhe në ë</p> <p>eb-in e institucionit. Nga takimi i GVJ zhvilluar në institucion me studentët, u evidentua që 3 nga 6 studentë studentët pjesëmarrës në takim ishin të punësuar në biznese natyra e të cilëve mbulohen nga ky program studimi, në bizneset e tyre familjare. Ky element është pozitiv sepse studentët mund të aplikojnë njohuritë në bizneset familjare por gjithashtu mund të zhvillojnë praktikat profesionale në një drejtim të caktuar që ka nevojë biznesi i tyre.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ky kriter plotësohet. Studentët komunikojnë me pedagogun nëpërmjet portalit EduPlatform për leksionet, detyrat e shtëpisë, detyrat kursit dhe për probleme të tjera që lidhen me lëndën. Ky sistem i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë, çdo student mund të logohet nëpërmjet e-mail dhe kredencialeve të tjera që parashikon institucioni.</p> <p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve nëpërmjet Fakultetit, Departamentit, NJSBC, Sekretarisë mësimore etj zyra e këshillimi të karrierës dhe Alumnit. Portali EduPage, platforma Microsoft Teams, Tutori akademik, komunikimi i drejtpërdrejtë në auditor si dhe rrjeteve sociale të KU LOGOS.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="646 1400 837 1489">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="837 1400 1013 1489">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1013 1400 1220 1489">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1400 1394 1489">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="646 1489 837 1545"></td> <td data-bbox="837 1489 1013 1545"></td> <td data-bbox="1013 1489 1220 1545"></td> <td data-bbox="1220 1489 1394 1545">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron	Institucioni disponon një sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe





të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	aktivitetet e tyre nga regjistrimi në diplomim nëpërmjet Edupage, Microsoft teams etj. Institucioni disponon gjithashtu statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit (nga takimi me përfaqësues të sekretarisë mësimore) . Gjatë vitit akademik 2019-2020 evidentohen të regjistruar 6 studentë në PS DPAGB.			
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	KU- LOGOS është i pajisur me një sistem menaxhimi të dedikuar që siguron akses për personelin e angazhuar në programin e studimit dhe studentët, me platformë që mundësojnë komunikimin interaktiv si Edupage, Microsoft teams.  Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin dhe dokumentacionin mbi aktivitetin e personelit akademik. Më konkretisht zyra e Burimeve njerëzore administron dhe koordinon aktivitetin dhe dokumentacionin e personelit.			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	11. - <i>Politika dhe procedura e Burimeve Njerëzore në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i> 44. - <i>Formati i dosjes personale te stafit.pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm si EduPage ofron informacione si për stafin e angazhuar në programin e studimit por edhe për studentët. Të dy këto platforma janë të institucionalizuara me rregulloret përkatëse.  39.1. - <i>Edupage.pdf</i> 39.2. - <i>Manual Edupage - Pedagoget - Reduktuar Mesimi Online.pdf</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Megjithatë praktika e paraqitur, kryesisht monitorimi nëpërmjet Teams nuk është e mjaftueshme, GVJ rekomandon zhvillimin e një praktike monitorimi edhe kur mësimi zhvillohet online.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. Megjithatë për PS DP AGB duhet të plotësohet informacioni për stafin e angazhuar në programin e studimit.  <a href="http://www.kulogos.edu.al/Programi%20Profesional%202-vjecar%20ne%20%20%20Agrobiznes%20me%20profile.pdf">http://www.kulogos.edu.al/Programi%20Profesional%202-vjecar%20ne%20%20%20Agrobiznes%20me%20profile.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteri 1 i këtij standarti plotësohet. Institucioni disponon procedurat dhe zbaton rregullore në lidhje me pranimin, vlerësimin dhe transferimin e studimeve të mëparshme. Kriteret e pranimit janë të paraqitura në një sërë dokumenta si <i>Rregullorja e KU LOGOS, 7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf, Faqja ëeb e KU LOGOS</i>. Në nenin 21 dhe 22 të rregullores së programit të studimit paraqiten kriteret e pranimit të studentëve për programin e studimit në shqyrtim. Programi i studimit profesional 2 vjecar Agrobiznes me Profile në Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor është i hapur për të gjithë maturantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe studen. It që duan të ndjekin një program të dytë studimi në programe profesionale 2 vjecare. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim dhe organizimi i konkursit bëhet nga Fakulteti i ekonomisë. GVJ gjykon që kolegji duhet të vendosë disa kriteret shtesë për të rekrutuar studentë të shkollave të mesme profesionale bujqësore.</p> <p><i>7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i></p> <p>Po kështu studentët mund të aksesojnë informacion për mënyrën e vlerësimit të dijeve gjatë vitit akademik. Këto informacione mund të sigurohen nga programet e lëndëve të cilat ju komunikohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse por edhe nga përfaqësues të zyrës së çështjeve studentore dhe Këshillimi të Karrierës dhe Alumni, si dhe instrumente të tjera të komunikimit si takimet nëpër gjimnaze, takime online me studentë, fletëpalosjet etj.</p> <p><i>48.1. - Rubrika e dedikuar studenteve nga plani strategjik 2018-2024.pdf</i></p> <p><i>Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i></p> <p><i>KESHILLIMI I KARRIERES ONLINE.pdf</i></p> <p><i>39.6. - Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me</i></p>



	<p><i>studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i></p> <p><i>LOGOS ëbsite.pdf</i></p> <p><i>48.2. - Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i></p> <p><i>41.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat në hyrje dhe dalje garantojnë barazinë për të gjithë studentët e programit të studimit.</p> <p>Institucioni paraqet që për programin e studimit në shqyrtim i jepet e drejta çdo studenti, pa dallim, i cili ka mbaruar shkollën e mesme. Ky është kriter i cili duhet plotësuar. Politikat dhe procedurat e kolegjit, nuk përmbajnë asnjë kriter tjetër skualifikimi, të gjithë studentët kanë të drejtën e aplikimit dhe kanë të drejta të barabarta. Megjithatë GVJ rekomandon që edhe pse ligji nuk parashikon aktualisht një kriter aksesues, duhet të vendosen kritere minimale për të aksesuar në një program të tillë studimi.</p> <p><i>7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i></p> <p><i>6.2. - RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nuk ka kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë program studimi. Përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimi nëpërmjet burimeve dhe instrumentave të ndryshëm të komunikimit. Këshillimi i karrierës i cili është realizuar online për shkak të pandemisë. Po kështu pjesëmarrjet në panairt e punës janë një tjetër burim informimi për ekzistencën e programit të studimit.</p> <p><i>39.6. - Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i></p> <p><i>47.1 - LOGOS ëbsite.pdf</i></p> <p><i>51.1 - Pjesëmarrja në Panairt e Punës.pdf</i></p> <p><i>51.2. -- Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i></p> <p><i>51.3.4. - KESHILLIMI I KARRIERES ONLINE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Departamenti i Agrobiznesit, Zyra e Karrierës dhe sekretarisa vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen e procedurat e zbatuara për përparimit akademik dhe kalimin e studentëve nga një vit në vitin pasardhës në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregullorja e KU LOGOS, rregullorja e FE, rregullorja e sekretarisë mësimore dhe rregullorja e programit të studimit.</p> <p><i>6.2. - RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët</p>	<p>Ky kriter plotësohet, studentët informohen për procedurat e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	vlerësimit të dijeve si dhe procedurat e diplomimit. Këto informacione janë të detajuara në syllabuset e lëndëve si dhe në rregulloren e programit të studimit. <i>7.2. - Rregullore Progr Stud Agrobiznes (E RISHIKUAR).pdf</i> <i>6.2. - RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf</i> <i>MFB Vleresimi i pedagogut udheheqes_.doc</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton se, institucioni dëshmon se cdo vit publikon udhëzues për programet e studimit, për kriteret, për kuotat e pranimit. Institucioni ofron informacion në mënyrë të vazhdueshme nga të gjitha zyrat që lidhen direkt dhe indirekt me studentin. <i>39.6. - Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i> <i>47.1 - LOGOS ëbsite.pdf</i> <i>51.1 - Pjesëmarrja në Panairët e Punës.pdf</i> <i>51.2. -- Materialet dhe broshurat informuese për studentin...pdf</i> <i>51.3.4. - KESHILLIMI I KARRIERES ONLINE.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Departamenti i Agrobiznesit në Fakultetin Ekonomik, në KU LOGOS ofron informacion të vazhdueshëm në lidhje me strukturën e organizimit të programit, me fletpalosje, broshura dhe me çdo mjet tjetër komunikimi që Kolegji disponon si E-mail, facebook, Instagram, Nr.kontakti, email etj.dhe informacionit të marrë nga njësitë përgjegjëse, (sekretaria, zyra e karrierës dhe departamenti). Ky informacion paraqitet i detajuar në ëeb. Në këtë të fundit studentët apo palë të tjera të interesuar informohen në lidhje me objektivat e programit të studimit, mundësitë e punësimit si informacione në lidhje me organizimin e programit, lëndët, kreditet, kohëzgjatjen e etj.  <a href="http://www.kulogos.edu.al/Programi%20Profesional%202-vjecar%20ne%20%20%20Agrobiznes%20me%20profile.pdf">http://www.kulogos.edu.al/Programi%20Profesional%202-vjecar%20ne%20%20%20Agrobiznes%20me%20profile.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të	Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Gjithashtu u krijon mundësi studentëve të zhvillojnë praktikën në një nga operatorët e biznesit bujqësor me të cilin KU LOGOS ka nënshkruar marrëveshje. Nga takimi i GVJ me studentët e programit të studimit në Agrobiznes me profile “Menaxhim i Fermës Bujqësore” dhe “Marketing i Produktit Bujqësor” shumica e studentëve kishin një biznes bujqësor familjar I cili përbënte dhe motivin kryesor të përzgjedhjes së këtij programi studimi.</p> <p><i>MPB Logos Formular i miratimit te praktikës nga Departamenti.doc</i></p> <p><i>MPB Logos Relacion mbi zhvillimin e Praktikës.doc</i></p> <p><i>MPB Vleresimi i pedagogut udhëheqes.doc MPB, Raport vleresimi nga mbikqyresi i praktikës.doc</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët që ndjekin këtë program studimi informohen vazhdimisht nga strukturat si departamenti i Agrobiznesit, sekretaria mësimore, pedagogët si dhe zyra e këshillimit. Numri i ulët i studentëve bën që komunikimi të jetë i suksesshëm.</p> <p><i>39.6. - Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i></p> <p><i>39.3. - Njoftimet dhe komunikimet për trajnimet e platformave të reja digjitale.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni për lëndët dhe detyrimet e tjera në kuadër të programit të studimit mundësohen përmes platformës online Edupage e cila aksesohet nga studentët në distancë. Në këtë platformë studenti informohet në kohë realë për leksionet, detyrat, vlerësimet etj.</p> <p><i>39.1. - Edupage.pdf</i></p> <p><i>55.2.. Rektorati-urdher - platforma digjitale (3).pdf</i></p> <p><i>55.3. SA- udhezim per politiken e vleresimit ne distance.pdf</i></p> <p><i>55.4. Rektorati-urdher - platforma digjitale.pdf</i></p> <p><i>55.5. Udhezues per mesimin ne distance per studentet-2020.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
<p style="text-align: right;"><b>X</b></p>				

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishtme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar si dhe për numrin e studentëve në vitet paraardhëse. Këto informacione u siguruan nga vizita në institucion, pranë sekretarisë mësimore por janë të aksesueshme edhe te raporti vjetor i analizës së departamentit të Agrobiznesit.</p> <p>- ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike si dhe statistikat vjetore të studentëve të regjistruar dhe tërhequr nga programi janë plotësuar në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Kjo u evidentua dhe nga verifikimi i elementëve të mësipërm në institucion.</p> <p>- ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të vazhdueshme për perparimin akademik të studentëve, procesverbalet lëndore, vlerësimet si dhe statusin e studentëve në cdo lëndë. KU Logos parashikon në rregulloren e programit të studimit si dhe zyrat e tjera hartimin e raporteve për cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje. Ky informacion është i disponueshëm edhe në dokumentin Analiza vjetore e Departamentit të Agrobiznesit për vitin 2019-2020. Po kështu në regjistrin themeltar regjistrohen edhe vlerësimet për modulet përkatëse.</p> <p>- ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në rregulloren e sekretarisë mësimore paraqiten detyrat e saj në plotësimin e evidencave për studentët e regjistruar në programin e studimit sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga MASR dhe KU LOGOS. Dokumentacioni ruhet në regjistrat e sekretarisë mësimore si dhe në bazën e të dhënave të sistemit Office 365 dhe Edupage.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhen nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit, në të këtë të fundit ruhet informacioni për ecurinë akademike të studentëve nga një vit në tjetrin.</p> <p>9. - Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur raport analitik për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve në analizën e veprimtarisë së Departamentit të Agrobiznesit. Megjithatë deri tani nuk ka një plan masash për përzgjedhjen e studentëve cilësorë nga shkollat e mesme të cilët dëshirojnë të punësohen në sektorin bujqësor. Po kështu koha e implementimit të programit të studimit është e shkurtër për të gjykuar për përmirësimin e indikatorëve që lidhen me cilësinë në hyrje, dalje dhe punësimin e studentëve.</p> <p>38. - ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT.pdf</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfshirja dhe angazhimi i studentëve parashikohet në statutin e KU-LOGOS, gjithashtu është garantuar pjesëmarrja në këshillin studentor, në senatin akademik, në komisionin e sigurimit të cilësisë.  <i>62. - Organizimi i zgjedhjeve te Keshillit Studentor(1).pdf</i>  <i>62.1.- FLETET E VOTIMIT TE STUDENTEVE.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KU logos përfshin vazhdimisht studentët në procese anketimi në lidhje me cilësinë e mësimin dhe programit të studimit në tërësi. Këto instrumenta i vijnë në ndihmë për të marrë feedback në lidhje me cilësinë e procesit akademik si dhe çështje të tjera që ndikojnë në realizmin me cilësi të programit të studimit.  <i>41. 1. KU LOGOS-Formular vleresimi per mesimin ne distance 2020 studenti.pdf</i>  <i>41.2 KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>  <i>41.2. - KU LOGOS-Formular vleresimi per perdorimin e platformave digitale 2020-student.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	GVJ ka paraqitur më sipër argumentat për nevojën që ka ky program studimi për tu përshtatur me specifikat e një programi diplome profesionale. GVJ gjykon që programi ka një përmbajtje të konsiderueshme teorike dhe që ka nevojë për tu lehtësuar nga ky drejtim duke u fokusuar më shumë në pjesën praktike të njohurive të ofruara në menaxhimin e agrobiznesit.  <i>19.1 - Plani mesimor 2019-2020.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>  <i>19.2 - 2019-2020 SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.3 - PLANI MESIMOR 2020-2021.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 - SYLLABUS - SHQIP.pdf</i>  <i>19.4 - 2020-2021 SYLLABUS - ANGLISHT.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton	Rekomandohet për institucionin të pajiset me një praktikë konkrete

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascl.al

Web site: [www.ascl.al](http://www.ascl.al)

përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	që garanton përfshirjen e studentëve në hartimin dhe rishikimin e programit të studimit bazuar në feedback-un që marrin nga tregu i punës. Përfshirja e një pyetësori në lidhje me modulet dhe se si studentët i gjejnë ato mund të jetë një nga opsionet.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u jepet mundësia të shprehen në lidhje me cilësinë dhe ndershmërinë e procesit të kontrollit të njohurive si dhe ankimimit të rezultateve. Kjo praktikë është e institucionalizuar në rregulloren e Fakultetit Ekonomik.  5. - Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS".pdf  6.1. - Rregullore e Fakultetit Ekonomik.pdf 6.2. - RREGULLORE E DEPARTAMENTIT AGROBIZNESI.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Nga konsultimi i dokumentacionit dhe vizita në KU-LOGOS evidentohen mjetet e brendshme të jashtme të komunikimit me studentët. Portali EduPage, platforma Microsoft Teams, Tutori akademik, komunikimi i drejtpërdrejtë në auditor si dhe rrjeteve sociale të KU.  <i>Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS.pdf</i>  47.1 - LOGOS ebsite.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës është njësi që pret studentët, informon këshillon në lidhje me programet e studimit në KU LOGOS. Kjo zyrë ka për qëllim të ndihmojë studentët në krijimin e lidhjeve me punëmarrësit potencialë, ti njohë ata me tregun e punës si dhe të mundësojë ndërtimin e një rrjeti aktorësh që do të mundësojnë punësimin e studentëve të diplomuar. Gjithashtu kjo zyrë ofron edhe shërbim në drejtim të organizimit të ëorkshopeve që kanë në qendër studentin, trajnime, mundësi për zhvillimin e shkollave verore etj. Nga takimet me stafin e angazhuar në këtë zyrë u vu re një frymë dinamike dhe bashkëpunuese me studentët e regjistruar në programin e studimit Agrobiznes me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bujqësore” <i>12. - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës.pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Në nenin 4 të Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës paraqiten funksionet dhe shërbimet e Zyrës së Këshillimit dhe ndër to përmendet edhe bashëpunimi me departamentet për vijueshmërinë e praktikave profesionale, ndjekjen e ecurisë së tyre. Gjithashtu kjo zyrë ka si funksion edhe mbajtjen e marrëdhënies me Alumni. Aktualisht nuk disponohen të dhëna për punësimin dhe indikatorë të tjerë që lidhen me të sepse është kohorti i parë i studentëve të diplomuar. <i>12. - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës.pdf</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhimi i Fermës Bujqësore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Koleji Universitar Logos”**



**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Infrastruktura e plotë dhe cilësore që ofron institucioni për zhvillimin normal të programit të studimit.
2. Staf i akademik i përkushtuar
3. Lokacioni dhe vendodhja e KU LOGOS
4. Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik.
5. Angazhimi i drejtuesve të lartë të institucionit, eksperienca dhe mundësitë që ata ofrojnë në funksion të kolegjit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


6. Mundësi të mira për network me Universitete partnere sidomos në Greqi të cilat i mundësojnë rritje të kapaciteteve të stafit si dhe akses në infrastrukturën akademike online (librari apo databaza shkencore).
7. Studentët të angazhuar me lidhje direkte me tregun e punës (shumica punojnë në bizneset familjare).

### **Pika të dobëta**

1. Programi i studimit ka mangësitë si më poshtë:
  - a) Në lëndët bazë nuk ofrohet një lidhje direkte me titullin që ai lëshon
  - b) Mungesa në planin mësimor të lëndëve të marketingut që do të zhvillojnë kompetencat e duhura tek studentët, në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme që ky program deklaron;
  - c) Në programin e studimit ofrohen 3 lëndë në fushën e marketingut që ofrojnë të njëjtat kompetenca,
  - d) Përmbajtja e lëndëve shpesh bie ndesh me nivelin e programit si dhe me dijet që studentët pritet të përftojnë. Përfshirja i regresioneve lineare, probabilitare apo dhe teknikave të tjera të sofistikuar ekonometrike në metodat e analizës bie ndesh me nivelin e dijes dhe lëndët e tjera që ofrohen.
  - e) Në programin e studimit sidomos në lëndët e lidhura me menaxhimin e fermës ofrohen lëndë për pjesën agronomike të produkteve bujqësore që nuk pasqyrojnë realitetin dhe vizionin e bujqësisë shqiptare. Produktet kryesore me peshë të lartë për bujqësinë shqiptare dhe për eksportet që siç janë bimët aromatike dhe mjekësore, perimet e serave, blegtoria etj, nuk studiohen. Kjo është e rëndësishme sidomos për përgatitjen e studentëve për tregun e punës.
  - f) Syllabuset e lëndëve nuk parashikohet dosja praktike e studentëve, që përbën një detyrim ligjor
  - g) Mungesa e syllabusit të praktikës profesionale si dhe kompetencat e përftuara
2. Numër i vogël i studentëve të rregjistruar në programin e studimit DPAGB.

### **Rekomandime**

1. Rekomandohet një studim tregu më i detajuar mbi të cilin është mbështetur hartimi i programit si dhe një analizë e praktikave më të mira ekzistuese (benchmarking) për të justifikuar programin ekzistues.
2. Rekomandohet një rishikim i programit të studimit dhe kompetencave që ai ofron për studentët e targetuar në DPAGB.
3. Rishikimi i syllabuseve dhe lëndëve që lidhen me profilin e marketingu dhe optimizimi i PS në drejtim të lëndëve me karakter praktik.





4. Rekomandohet rishikim i syllabuseve të profilit Menaxhim Ferme ku të përfshihen njohuri që kanë lidhje me aktualitetin dhe të ardhmen e Bujqësisë shqiptare.
5. Rekomandohet përshtatja përmbajtësore e lëndëve me nivelin e studentëve.
6. Rekomandohet parashikimi dhe shtimi i orëve të praktikës mësimore veçanërisht për lëndë që kanë orientim praktik.
7. Rekomandohet që në profilin menaxhim i fermës bujqësore të përfshihen njohuri edhe për fermat blegtorale, pasi zënë një peshë të rëndësishme për bujqësinë shqiptare.
8. Futja e lëndëve të marketingut është një nevojë për të përshtatur programin e studimit me titullin e profilit të lëshuar.
9. Biblioteka e institucionit duhet të azhurnohet me titujt e botimeve të fundit, të shtojë numrin e titujve që lidhen direkt me PSAGB.

**Conclusions of the Evaluation of the study program with professional character "Agribusiness" with profiles "Agricultural Product Marketing" and "Agricultural Farm Management" of the Higher Education Institution "Logos University College"**

**Strengths and affirmations**

1. Complete and quality infrastructure provided by the institution for the normal development of the study program.
2. Dedicated academic staff.
3. Location of "Logos University College"
4. Experience and qualifications of the academic staff.
5. The commitment of the top leaders of the institution, the experience and the opportunities they offer in the function of the college.
6. Good networking opportunities with partner universities, especially in Greece, which enable the increase of staff capacities as well as access to the online academic infrastructure (library or scientific database)
7. Students engaged with direct links to the labor market (most work in family businesses).

**Weaknesses**


1. The study program has the following shortcomings:
  - a) Basic courses do not provide a direct link to the title it issues.
  - b) Lack in the curriculum of marketing subjects that would develop the necessary competencies in students, in accordance with the objectives and expected results that this program states.




- c) The study program offers 3 courses in the field of marketing that offer the same competencies.
  - d) The content of the courses often conflicts with the level of the program as well as with the knowledge that students are expected to acquire. The inclusion of linear, probabilistic regressions or other sophisticated econometric techniques in the methods of analysis conflicts with the level of knowledge and other subjects offered.
  - e) In the study program, especially in courses related to farm management, courses are offered for the agronomic part of agricultural products that do not reflect the reality and vision of Albanian agriculture. The main products with high weight for Albanian agriculture and for exports that such as aromatic and medicinal plants, greenhouse vegetables, livestock, etc., are not studied. This is especially important for preparing students for the job market.
  - f) Course syllabi are not provided for the practical file of students, which constitutes a legal obligation.
  - g) Lack of syllabus of professional practice and acquired competencies.
2. Small number of students enrolled in the DPAGB study program.

### **Recommendations**

1. A more detailed market study on which the program design is based is recommended as well as an analysis of existing best practices (benchmarking) to justify the existing program.
2. A review of the study program and competencies it provides for DPAGB target students is recommended.
3. Review of syllabi and courses related to the marketing profile and optimization of the SP in terms of practical courses.
4. It is recommended to review the syllabi of the profile Farm Management to include knowledge related to the current and future of Albanian Agriculture.
5. It is recommended to adapt the content of the courses to the level of the students.
6. It is recommended to anticipate and increase the hours of teaching practice, especially for subjects that have a practical orientation.
7. It is recommended that the management profile of the agricultural farm include knowledge about livestock farms, as they occupy an important weight for Albanian agriculture.
8. The introduction of marketing subjects is a need to adapt the study program to the title of the profile issued.
9. The library of the institution should be updated with the titles of the latest publications, increase the number of titles directly related to PSAGB.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	